

---

## BULETIN INFORMATIV

---

Nëntor 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE  
E SHQIPËRISË

---



---

**Buletin mujor i aktiviteve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë**

Nëntor, 2024

## Përmbajtje

<b>Aktivitete .....</b>	<b>5</b>
U zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare “Në 80-vjetorin e Çlirimit të Shqipërisë nga pushtimi nazifashist” .....	6
Tryezën shkencore ndërkombëtare: "Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj" / "Albanian among the Indo-European Languages: origins and antiquity" ....	12
"Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj" .....	14
Albanologët e huaj dhe vendës përfunduan tryezën shkencore ndërkombëtare “Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj”, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti "Ludwig Maximilian" i Mynihut .....	19
Kuvendi kombëtar për gjuhën shqipe “Sfidat e Gjuhës Shqipe në shekullin XXI” .....	25
Akademia e Shkencave prezanton projektin e veprës “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” .....	29
Fjala e Kryetarit të ASHSH në promovimin e librit "Përrallëtarët e gjuhës shqipe" i autorit Ardian Vehbiu, anëtar i jashtëm i ASHSH .....	33
Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Horizonti AI - një epokë e re kreativiteti dhe inovacioni” .....	36
Fjala e Kryetarit të ASHSH akad. Gjinushi në konferencën ndërkombëtare “Horizonti AI - një epokë e re kreativiteti dhe inovacioni” .....	39
U zhvillua konferenca “Bektashizmi shqiptar në Luftën e Dytë Botërore” .....	43
Bujqësia e zgjuar në Shqipëri, arritje dhe sfida për të ardhmen.....	46
Konferencë shkencore ndërkombëtare me rastin e 75-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Republikës Popullore të Kinës dhe Republikës së Shqipërisë .....	49
U zhvillua seminari “Cilësia e ajrit dhe frymëmarrja e shëndetshme tek fëmijët (çerdhe-kopshte-shkolla) dhe ventilimi smart i tyre” .....	53
Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua më datë 16 tetor 2024 Workshopi “Tranzicioni Energjitik dhe Shqipëria” .....	56
U zhvillua konferenca shkencore me temë: "Ripërtëritja e historisë" .....	58
U zhvillua forumi akademik “Mbi vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore” .....	61
U zhvillua konferenca e 1-rë kombëtare: “Kanceri i gjirit, vëmendje jo vetëm në tetor: të	

dhëna epidemiologjike, klinike dhe eksperiencia e Shqipërisë” .....	64
Akademia e të Rinjve bashkorganizatore e Simpoziumit shkencor “Gjuha dhe identiteti kombëtar”, ku prezantohet ARSH si pjesë e turit në institucionet e arsimit të lartë në vend .	69
Akademik Ilirjan Malollari dhe akademik Kosta Barjaba, në Forumin Botëror të Shkencës në Budapest.....	70
Konferenca shkencore “Attraversamenti mediterranei” .....	73
U zhvillua workshop-i “Bujqësia e zgjuar në Shqipëri, arritje dhe sfida për të ardhmen” .....	76
<b>Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH.....</b>	<b>80</b>
Zhvillohet mbledhja e radhës e komisionit të mjekësisë me temën “Sëmundjet autoimune, epidemiologjia dhe roli i tyre në sëmundshmërinë e përgjithshme” .....	81
<b>Vlerësime .....</b>	<b>84</b>
Akademik Anastas Angjeli vlerësohet me çmimin e karrierës në Panairin e 27-të librit .....	85
Akad. Nazim Gruda zgjidhet si shkencëtar i shquar nga Akademia e Shkencave e Kinës .....	87
Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi vlerësohet me çmimin “Sami Frashëri” për veprën monografike historike "Wilhelm zu Wied dhe Shqipëria” .....	88
<b>Promovime.....</b>	<b>90</b>
U prezantua botimi “Sfidat e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri e rajon”, botim i përbashkët i ASHSH dhe ASHAK.....	91
U përrua libri "Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike", vëllimi III ..	92
U përrua libri “The earthquake of 26 november 2019 and what can we learn" me autorë akad. asoc. Rrapo Ormënin dhe Serkan Öztürk .....	95
U përrua vepra "Historiografia e artit të tingullit në botën shqiptare (nga prehistoria në antikitet)", me autor prof. dr. Edmond Buharaja, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.....	97
Përruhen librat “Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore” dhe “Krijimtaria letrare e Ali Aliut”, botime të dy akademive të shkencave Shqipëri-Kosovë .....	100
Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u bë sot promovimi i librit “Përrallëtarët e gjuhës shqipe” të autorit Ardian Vehbiu, botim i shtëpisë botuese “Naimi” .....	103
Në sallën "Akademikët" të ASHSH u promovua libri "Kompleksi ligatinor i Kune-Vainit (Lezhë, Shqipëri) - qasja ekologjike" .....	107

---

# **Aktivite**

## U zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare “Në 80-vjetorin e Çlirimit të Shqipërisë nga pushtimi nazifashist”

Sot, më 25 nëntor 2024, me rastin e 80-vjetorit të Çlirimit të shpallur si vit jubilar mbarëkombëtar nga Këshilli i Ministrave, Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave e Arteve të Kosovës zhvilluan një konferencë shkencore ndërkombëtare.



Sesionin e parë të kësaj konference e moderuan prof. dr. Paskal Milo, dr. Roderick Bailey e prof. dr. Bujar Dugolli.

Fillimisht prof. dr. Milo përshëndeti të pranishmit dhe i dha fjalën e hapjes së kësaj veprimtarie Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushit.



Akad. Gjinushi u shprehu të pranishmëve urimet për festën e 80-vjetorit të Çlirimit të vendit dhe falënderoi organizatorët e konferencës dhe pjesëmarrësit nga Kosova, Maqedonia



---

e Veriut, nga Akademia Ushtarake dhe Akademia e Policisë, etj.

Ai theksoi ndër të tjera, se qasja ndaj rolit të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut, një nga ngjarjet më të mëdha e më tragjike të njerëzimit, ka të bëjë jo thjesht me qëndrimin ndaj një periudhe historike, por me vlerësimin e një prej tipareve më të vyera të një populli, atë të antifashizmit, tipar themelor ky i popujve sot, në botën demokratike.

Konferencën e përshëndeti edhe z. Skënder Durmishi, ambasador i Republikës së Kosovës. Ai foli për përpjekjet që kanë bërë kosovarët për të qenë në vijën e parë të frontit të luftës për çështje të pavarësisë dhe lirisë.

Më pas prof. dr. Paskal Milo, mbajti kumtesën "Shqipëria antifashiste në anën e duhur të historisë në Luftën e Dytë Botërore. Ai theksoi se Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe rreshtimi krahas Aleatëve të Mëdhenj të Kombeve të Bashkuara forcoi pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë dhe e shpëtoi atë nga disa përpjekje që u bënë pas Luftë për t'i cenuar integritetin territorial dhe ndërhyrjen në punët e brendshme.

Studiuesi italian, prof. Alberto Basciani, foli për figurën e prof. Gjeneral Parianit dhe fundin e sundimit italian në Shqipëri (mars - shtator 1943). Në fillim të marsit 1943, situata italiane në Shqipëri pësoi një kthesë të bujshme. Francesco Jacomoni (Françesko Jakomoni) dha dorëheqjen si mëkëmbës dhe në vend të tij u emërua nga Musolini Alberto Pariani. Por, ai u vendos në një situatë komplekse, që nuk e kishte imagjinuar, tha prof. Basciani.

Akad. Pëllumb Xhufi mbajti kumtesën "Kolaboracionizmi në Luftën e Dytë Botërore: rasti shqiptar". Ai pasi bëri një përshkrim të forcave aleate dhe kundërshtarë që morën pjesë në luftë theksoi se dokumente të shumta të pushtuesve italianë e gjermanë, të misioneve aleate anglo-amerikane, të qeverive kuislinge e të organizatave Balli Kombëtar e Legaliteti provojnë qartë se parulla e së ashtuquajturës "Shqipëri Etnike" që ata përdorën gjatë viteve të luftës për të përlligjur kolaboracionizmin e tyre, ishte thjesht e vetëm propagandë. Në fakt, ata nuk munguan të iniciojnë marrëveshje me qarqet antishqiptare fqinje për përfshirjen e Shqipërisë, pa Kosovën e Çamërinë, si njësi federale në kuadrin e shtetit jugosllav apo të atij grek.

Dr. Roderick Bailey, University of Oxford, foli për ndikimin e Luftës në Shqipëri në trupat dhe mendjet e personelit britanik, duke iu referuar burimeve nga dokumente të deklasifikuara dhe nga materiale të tjera bashkëkohore të mbledhura nga personeli britanik dhe familjet e tyre.

Prof. dr. Et'hem Çeku foli për zhvillimin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Kosovë. Ai theksoi se përfshirja e Kosovës në Luftën Nacionalçlirimtare, në zbatim të thirrjes së aleatëve të mëdhenj antifashistë, bëri që Kosova të ruante tërësinë e saj territoriale dhe shumicën e popullsisë shqiptare që jetonte aty. Kjo luftë ndikoi që Kosova të fitonte një subjektivitet të veçantë, që do të ndihmonte në zhvillimin dhe, më vonë, në formimin e mëvetësisë së saj.

Prof. dr. Sonila Boçi mbajti kumtesën "Nga Peza në Berat: një vështrim analitik mbi ngritjen dhe strukturimin e Frontit Nacionalçlirimtar në Shqipëri". Ajo u përqendrua në

analizën e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që siguruan masivizimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe suksesin e saj si në çlirimin e Shqipërisë, ashtu edhe në rrugëtimin e PKSH-së drejt pushtetit.

Sesioni i dytë u drejtua nga prof. dr. Hamit Kaba, prof. dr. Et'hem Çeku, prof. asoc. dr. Elias G. Skoulidas.



Prof. asoc. dr. Elias G. Skoulidas, Universiteti i Janinës, mbajti një kumtesë për format e bashkëpunimit midis shqiptarëve dhe grekëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai shprehu interesin për të diskutuar në kuadër të bashkëpunimit në Ballkan gjatë Luftës së Dytë Botërore. Objektivi ynë është që të shqyrtojmë proceset e veçanta, bazuar kryesisht në burimet më të fundit arkivore greke e shqiptare të disponueshme, si dhe të shteteve të tjera. -tha Skoulidas. Ai e vuri theksin tek bashkëpunimet greko-shqiptare gjatë Luftës Civile Greke dhe fillimit të Luftës së Ftohtë, veçanërisht në kontekstin e “strategjisë së përmbytjes” dhe “politikës së Rollback-ut”.

Akad. Hamit Kaba foli për Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe qëndrimin e diasporës shqiptare gjatë kësaj lufte. Ai trajtoi raportet e emigracionit shqiptar dhe përfaqësuesve të tyre me Lëvizjen Nacionalçlirimtare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Emigracioni shqiptar ruajti karakterin antifashist, por mbeti i ndarë e i përçarë dhe nuk arriti që të realizonte të gjitha objektivat që i kishte vënë vetes për afrimin dhe afirmimin e Shqipërisë me Aleancën Antifashiste.

Prof. dr. Skënder Asani dhe prof. dr. Isamedin Azizi u prezantuan me kumtesën “Kontributi i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut për luftën nacionalçlirimtare dhe bashkëpunimi me Luftën Nacionalçlirimtare të Shqipërisë.” Në shtjellimin e kësaj teme ata u



përqendruan në formimin e formacioneve të veçanta shqiptare, që morën pjesë aktive në çlirimin e të gjitha qyteteve të Maqedonisë Perëndimore, duke u bërë kështu një nga brigadat më aktive për çlirimin e plotë të Jugosllavisë.

Akad. Vasil S. Tole mbajti kumtesën “Këngët partizane, trashëgimia shpirtërore e Luftës Antifashiste”. Ai trajtoi rolin që kishte muzika patriotike dhe gjinitë e saj të veçanta si: kënga, himni, marshi, elegjia, etj., gjatë luftës për çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashistë. “Këto këngë janë pjesë e pandashme e trashëgimisë muzikore shpirtërore patriotike të popullit shqiptar, e cila filloi të krijohet në gjysmën e dytë të shekullit të XIX-të, me muzikën patriotike qytetare kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 1878, që vijoi me opusin qendror të muzikës patriotike të Rilindjes sonë Kombëtare, pjesë e së cilës është edhe “Himni Kombëtar” dhe që mbyllet natyrshëm me këngët e periudhës 7 prill 1939-9 maj 1945, ose me këngët patriotike të Luftës së Dytë Botërore.”-tha akad. Tole.



Më tej u fol për rolin e Diasporës në Luftën e Dytë Botërore.

Prof. dr. Bujar Dugolli mbajti kumtesë për Drenicën gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa prof. Hajredin Isufi foli për Lëvizjen Antifashiste në Çamëri gjatë kësaj luftime. Hajredin Isufi foli për Lëvizjen Antifashiste në Çamëri në Luftën e Dytë Botërore.

Prof. asoc. dr. Ardit Bido mbajti një kumtesë për shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai trajtoi veçorinë e rastit shqiptar, si i vetmi vend evropian që kishte më shumë hebrenj në fund të Luftës sesa përpara saj. Në këtë kumtesë do të evidentohen përpjekjet e forcave antifashiste, por edhe të qeverive bashkëpunëtoresh shqiptare, në shpëtimin e hebrenjve, çka përbënte një sfidim të drejtpërdrejtë të ideologjisë naziste.

Seanca e tretë u drejtua nga prof. dr. Petrit Nathanaili, prof. dr. Skënder Asani, prof. dr. Ksenofon Krisafi.

---

Gjatë kësaj seance, prof. dr. Ksenofon Krisafi foli për marrëdhëniet e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare shqiptare me Fuqitë e Mëdha të kombeve të bashkuara antifashiste. Pozicioni i tyre ndaj Shqipërisë së pasluftës zuri fill te qëndrimi ndaj pushtimit fashist italian dhe në deklaratat e dhjetorit 1942, ku u shprehën se pas lufte do ta rinjihnin zyrtarisht shtetin e pavarur shqiptar. Deklarimet për afirmimin e të drejtës së shqiptarëve për ringritjen e shtetit të vet, për vendosjen e formës së qeverisjes dhe zgjedhjen e qeverisë që do të dëshironin, në përputhje me Kartën e Atlantikut, nuk e ndryshuan, pavarësisht nga zig-zaget që shoqëruan zhvillimet e mëvonshme si rezultat i interferencave të faktorëve të tjerë.

Prof. dr. Petrit Nathanaili foli për pushtimin italian i Shqipërisë dhe pasojat e tij në Ballkan dhe Mesdhe. Ai tha se Britania dhe Franca, të shqetësuar kryesisht për interesat e tyre, si fuqi të mëdha, nuk reagon ndaj këtij akti. Ato konsideruan më të nevojshme një aleancë me Turqinë, për shkak të paralelizmit mes interesave të tyre. Anglia dhe Franca vendosën të ndihmojnë Greqinë për ruajtjen e pavarësisë së saj dhe status quo-së në këtë rajon duke propozuar garantimin e Turqisë kundër çdo agresioni italo-gjerman në Mesdhe.

Akademik Marenglen Verli mbajti një m kumtesë për faktorët që penguan pushtuesit nazifashistë të kryenin rekrutim masiv në Kosovë. Ai theksoi se në Kosovë pati një lëvizje antifashiste, dhe në vitin 1944, aty ishin rreshtuar përkrah aleatëve antifashistë rreth 20 000 luftëtarë. Në fund të luftës numri kishte arritur në 53 000 të tillë.

Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi mbajti një kumtesë për karakterin e luftës së shqiptarëve dhe problematikat e trajtimit të saj. Ai analizoi disa nga problemet e hasura në dhjetëvjeçarët e fundit në trajtimet e historisë, e kryesisht mbi natyrën e luftës së shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Prof. dr. Irakli Koçollari mbajti një kumtesë për rezistencën nazifashiste në Shqipëri. Ai vuri në dukje mes të tjerash se SOE kishte për mision të organizonte dhe mbështeste veprimtari spiunazhi, sabotazhi apo lëvizjet e rezistencës së armatosur lokale, në Europën e pushtuar nga gjermanët.

Në fund, prof. dr. Bernard Zotaj paraqiti një kumtesë për dukuri të artit ushtarak në LANÇ dhe veçori të forcave luftarake. Ai theksoi se përvoja e forcave luftarake që morën pjesë aktive në LANÇ të popullit shqiptar është shumë dimensionale gjë që u vu re në fushën e organizimit luftarak dhe të artit ushtarak, të cilat jo vetëm duhet të njihen, por dhe të përkujtohen dhe nderohen me respekt dhe dinjitet.

Gjatë kësaj konference përmes punimeve shkencore u bë e qartë se shqiptarët zgjodhën rrugën më të drejtë për të rifituar lirinë dhe pavarësinë e tyre, përmes rezistencës antifashiste dhe luftës çlirimtare kundër shteteve pushtuese fashiste.

Ata për herë të parë me luftën e tyre u imponuan si subjekt e faktor ndërkombëtar dhe nuk lejuan të trajtoheshin si më parë në kulisat e politikës e të diplomacisë të Fuqive të Mëdha që vendosnin për fatin e tyre dhe të Shqipërisë pa i pyetur e duke i nëpërkëmbur. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe rreshtimi krahas Aleatëve të Mëdhenj të Kombeve të Bashkuara forcoi pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë dhe e shpëtoi atë nga disa përpjekje që

---

u bënë pas Luftë për t'i cenuar integritetin territorial dhe ndërhyrjen në punët e brendshme,  
etj.

---

## Tryezën shkencore ndërkombëtare: "Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj" / "Albanian among the Indo-European Languages: origins and antiquity"

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë Krahasuese dhe Indoeuropiane, si dhe të Albanologjisë, pranë Universitetit "Ludwig Maximilian" të Mynihut organizoi dhe sot tryezën shkencore ndërkombëtare: "Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj" / "Albanian among the Indo-European Languages: origins and antiquity".

[#Ashsh](#)

[#ludwigmaximilianuniversity](#)

[#Science](#)

[#paulheggarty](#)

[#olavhackstein](#)

[#gjuhashqipe](#)

[#albanologjia](#)

Kjo veprimtari shkencore mbahet në dy ditë, në datat 4-5 nëntor 2024, ku do të referojnë mbi 25 studiues e personalitete të rëndësishme të shkencës nga vendi dhe Bota.

Veprimtaria u çel nga Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi

Përhëndesin personalitete të shquara si prof. dr. Olav Hackstein, drejtor i Institutit të Gjuhësisë Krahasuese dhe Indoeuropiane dhe të Albanologjisë pranë Universitetit "Ludwig Maximilian" të Mynihut; prof. Paul Heggarty ("Max Planck" Institute, kryeautor i artikullit për kronologjinë e gjuhëve të familjes indoeuropiane në revistën e mirënjohur "Science", 28 qershor 2023), prof. Giulio Imberciadori.

Vijojnë prezantimet shkencore, ku do të trajtohen të dhënat e gjuhësisë historike-krahasuese, që përcaktojnë origjinën e gjuhës së përbashkët indoeuropiane dhe të degëzimeve të saj, përfshi edhe shqipen.

Një nga çështjet që do të diskutohet (shih programin) është receptimi ose pritja e artikullit të revistës "Science" në debatin publik, në media dhe në mjediset shqiptare, që e përcaktonte shqipen 6000-vjeçare.

Ndër të tjera, për të plotësuar kuadrin e konfirmimit se sa e lashtë është gjuha shqipe, do të bëhen edhe prezantime të kërkimeve me metoda bashkëkohore nga fusha e arkeologjisë dhe gjenetikës në Shqipëri dhe Kosovë, që dëshmojnë se nga bashkëjetesa e popullsisë vendëse eneolitike (paraindoeuropiane) dhe asaj migracionere të bronzit të hershëm (indoeuropiane), që në mijëvjeçarin III para Kr. fillon procesi i gjatë i etnogjenezës së popullsisë protoshqiptare në Ballkanin Perëndimor.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

Shih dhe:

---

<https://ata.gov.al/.../shqipja-midis-gjuheve.../...>  
<https://cnn.al/.../origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes.../>  
<https://www.gazetatema.net/.../tryeze-shkencore...>  
<https://observerkult.com/shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://zhurnal.mk/origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes.../>  
<https://medial.mk/origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes-shqipe.../>  
<https://youtu.be/QgSc8XROpeM?si=dEGQBiBeXrajEWK9>  
<https://albanian.cri.cn/.../ARTIhIEvn9Xt8b5uWuVIE0Zn24110...>  
<https://ubtnews.com/tryeze-shkencore-nderkombetare.../>  
<https://youtu.be/QgSc8XROpeM?si=OBPwksmgjWO-ua5e>  
<https://frekuenca.net/.../45100-shqipja-midis-gjuheve...>  
<https://youtu.be/QgSc8XROpeM?si=AWOly-whiZEM0zSy>  
<https://www.mcntv.al/node/208771>  
<https://alb-spirit.com/.../shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://sot.com.al/.../shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://www.tellalli.al/studiuesi-paul-heggarty-gjuhet.../>  
<https://youtu.be/XkVjSlkFEMs?si=oSjTizt5EPyC2eS8>



## "Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj"

- Akad. Skënder Gjinushi: "Akademia jonë e Shkencave, albanologjinë, shkencat e identitetit, i ka pasur dhe i ka prioritet konstant. Zhvillimi e promovimi i tyre përbëjnë rolin e misionin kryesor të ASHSH sipas ligjit të saj" -

- Akad. Gjinushi: "Studimi që kanë realizuar prof. Paul Heggarty dhe 33 bashkautorët e nderuar në revistën "Science", duke i njohur shqipes si origjinë të përbashkët e pikënisje të identifikimit të saj një hershmëri relative prej 6-8 mijë vjetësh, zgjoi vëmendjen, jo vetëm ndër dijetarët albanologë, duke nxitur interesin te ne, që ta ftonim e organizonim këtë dëgjese me profesorin e këtë diskutim shkencor së bashku" -

- Akad. Gjinushi: "E vërteta shkencore ka nevojë të njihet e të pohohet. Shkenca, në dallim nga të tjerët, nuk rend të deklarojë, a ca më keq, të deformatojë e vulgarizojë një hipotezë, por punon fort ta provojë atë. Fatkeqësisht, teknologjitë e reja, ashtu siç kanë mundur e mundësojnë shkencëtarët të studiojnë evoluimin e universit, të njeriut, specieve e të gjuhëve që në zanafillë, ashtu dhe kanë bërë që shpesh faktet e rreme të besohen më shumë se e vërteta; që deklarimet abuzive e amatoreske të prevalojnë ndaj mendimit e provave shkencore; që edhe teza e hipoteza me bazë shkencore të kthehen në vulgare e qesharake". -



Fjalë përshëndetëse e kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi në konferencën shkencore ndërkombëtare të organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti për Gjuhësi Krahasuese-Indoeuropiane si dhe për albanologjinë i "Ludwig Maximilian University" (Mynih, Gjermani) -

I nderuar profesor Olav Hackstein;

I nderuar profesor Paul Heggarty;

Të nderuar akademikë dhe profesorë, miq e kolegë;

Kam kënaqësinë që në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë t'ju uroj mirëseardhjen dhe t'ju falënderoj që patët mirësinë t'i përgjigjeni pozitivisht ftesës sonë për të marrë pjesë në tryezën shkencore "Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj", për të cilën përgatitjet kanë nisur që prej afro dy vjetësh.



Falënderojmë në mënyrë të veçantë Institutin e Gjuhësisë Krahasuese dhe Indoeuropiane, si dhe të Albanologjisë, pranë Universitetit "Ludwig Maximilian" të Mynihut, që jo vetëm mbështeti nismën për këtë tryezë, por, me dashamirësinë dhe përgjegjësinë e mirënjohur të tij, si një institucion bashkorganizues, fuqizoi ndërveprimin pjesëmarrës me qendrat më të rëndësishme të albanologjisë europiane.

Kjo tryezë është një hap i mëtejshëm përparues në vazhden e arritjeve të Kuvendit të Dytë të Studimeve Albanologjike, që u organizua në Tiranë tre vjet më parë. Jemi shumë të gëzuar që një pjesë e madhe e referuesve të saj kanë riardhur për të kontribuar me mendimet e rezultatet më të reja të tyre.

Akademia jonë e Shkencave, albanologjinë, shkencat e identitetit, i ka pasur dhe i ka prioritet konstant. Zhvillimi e promovimi i tyre përbëjnë rolin e misionin kryesor të ASHSH sipas ligjit të saj. Ajo është e vëmendshme dhe gjithnjë vlerësuese ndaj vendit të stabilizuar të saj në kuadër të gjuhësisë krahasimtare, të indoeuropeistikës e të interesimeve të tjera shkencore, veçanërisht për gjuhën dhe trashëgiminë materiale e jomateriale të truallit shqiptar, e për këtë u është mirënjohëse të gjithë atyre që kontribuojnë në këtë drejtim.

Studimi që kanë realizuar profesor Paul Heggarty (Max Planck Institute) dhe 33 bashkautorët e nderuar në revistën "Science", duke i njohur shqipes si origjinë të përbashkët e pikënisje të identifikimit të saj një hershmëri relative prej 6-8 mijë vjetësh, zgjoi vëmendjen jo vetëm ndër dijetarët albanologë, duke nxitur interesin te ne që ta ftonim e organizonim këtë dëgjese me profesorin e këtë diskutim shkencor së bashku me ju që jeni këtu të pranishëm e që na nderoni aq shumë.



Në Shqipëri e ndër shqiptarët ka pasur një interes të jashtëzakonshëm në lidhje me perceptimin e të rejave që sollën rindërtuesit e pemës gjenealogjike indoeuropiane.

Si e tillë, kjo tryezë është një risi në zhvillimin e aktiviteteve tona, pasi një drejtim krejt i ri i kërkimit shkencor të gjuhësisë historike, me ndihmën e inteligjencës artificiale, bëhet strumbullari i këtij aktiviteti. Temat që i bashkërenditen referatit kryesor synojnë nxitjen e diskutimeve dhe debatit, si dhe përforcimin multidisiplinor të kërkimit shkencor.

Popujt janë të ndjeshëm ndaj origjinës së tyre e të gjuhës së tyre. Interesin e rrit fakti se, çfarë po konfirmohet me studimet e reja, jo vetëm që nuk shkon kundër arritjeve të indoeuropeistikës, por vjen në përforcim, saktësim e pasurim të tyre.

E vërteta shkencore ka nevojë të njihet e të pohohet. Shkenca, në dallim nga të tjerët, nuk rend të deklarojë, a ca më keq, të deformatojë e vulgarizojë një hipotezë, por punon fort ta provojë atë.

Fatkeqësisht, teknologjitë e reja, ashtu siç kanë mundësuar e mundësojnë shkencëtarët të studiojnë evoluimin e universit, të njeriut, specieve e të gjuhëve që në zanafillë, ashtu dhe kanë bërë që shpesh faktet e rreme të besohen më shumë se e vërteta; që deklarimet abuzive e amatoreske të prevalojnë ndaj mendimit e provave shkencore; që edhe teza e hipoteza me bazë shkencore të kthehen në vulgare e qesharake.

Gjysmë shekulli më parë shkencëtarët shqiptarë dhe kolegët e tyre albanologë, të



mbledhur në Tiranë, vlerësonin si suksesin më të rëndësishëm konfirmimin e tezave të gjuhësisë për burimin, origjinalitetin dhe hershmërinë e shqipes si një gjuhë indoeuropiane me lidhje e prejardhje nga ilirishtja, për ta lënë të hapur lidhjen e saj e të ilirishtes me protoilirishten a pellazgishten; studimin e rrugëtimit të saj që nga origjina; si dhe krahasimet me gjuhët e tjera, me bindjen se gjetjet e teknologjitë e reja do të ndihmonin në të ardhmen në këtë aspekt.

Kërkimet arkeologjike të dekadave të fundme, thuajse në të gjitha rastet shqiptaro-europiane, na bënë të njohur se kultura materiale e qytetërimeve në territorin tonë flet për një vijueshmëri mijërvjeçare të saj; ajo "flet më shqip" se rrugëtimi i shqipes, duke pasur avantazhin të flasë me artefakte të ruajtura nga nëntoka.



Ekspedita shqiptaro-zvicerane e Linit (Pogradec), e bashkëkryesuar nga profesor Ilir Gjipali dhe profesor Alfred Hafner, zbuloi një vendbanim palafit prehistorik të lashtë me një vjetërsi po tetëmijë-vjeçare. Kultura e Linit si një vendbanim kaq i lashtë në Europë, së bashku me të ngjashëm në atë zonë, mund të vendoset në sinkroni me kohën e domestikimit të popullsisë banuese dhe të lindjes së bujqësisë dhe degëve të para të ekonomisë neolitike.

Të dhënat krejtësisht të reja, të shërbyera nga profesor Paul Heggarty dhe kolegët e tij, duke ndjekur rrugë tjetër e lëndë tjetër, të çojnë tek e njëjta kronologji. Me siguri këto studime do të thellohen e pasohen nga të tjerë dhe kështu drita që vjen nga mijëvjeçarët do të bëhet më e qartë.

Duke ju rishprehur edhe një herë falënderimet tona dhe duke i uruar sukses të plotë tryezës, tani le t'ua lëmë fjalën të ftuarve tanë, profesorëve të nderuar.

Ju faleminderit për vëmendjen.

Shih dhe lajmet për veprimtarinë të pasqyruara në media:

<https://youtu.be/XkVjSlkFEMs?si=zf0Y3XcDsehQdY0t>

<https://www.gazetatema.net/.../fjale-pershendetese-e.../>

---

<https://cnn.al/.../origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes.../>  
<https://a2news.com/.../gjuhet-indoeuropiane-lashtesia-e...>  
<https://youtu.be/XkVjSlkFEMs?si=WArEUQT7jt2GojJ7/>  
<https://www.youtube.com/watch?v=y9mm8qz9p4M/>  
<https://zhurnal.mk/origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes.../>  
<https://medial.mk/origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes-shqipe.../>  
<https://youtu.be/y9mm8qz9p4M?si=gAmoIWJ7FTF39mfH>  
<https://ata.gov.al/.../shqipja-midis-gjuheve.../.../>  
<https://youtu.be/XkVjSlkFEMs?si=oSjTizt5EPyC2eS8>  
<https://albanian.cri.cn/.../ARTIhIEvn9Xt8b5uWuVIE0Zn2411.../>  
<https://a2news.com/.../gjuhet-indoeuropiane-lashtesia-e.../>  
<https://youtu.be/bE15b3MyvNQ?si=9HL3M8gHs640h1kn>  
<https://www.youtube.com/watch?v=y9mm8qz9p4M>  
<https://telegafi.com/origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes.../>  
<https://www.kultplus.com/.../shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://www.oranews.tv/.../shqipja-ne-tri-me-te-vjetrat.../>  
<https://alfapress.al/.../studiuesi-paul-heggarty-gjuhet.../>  
<https://observerkult.com/shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://ubtnews.com/tryeze-shkencore-nderkombetare.../>  
<https://frekuenca.net/.../45100-shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://www.mcntv.al/node/208771>  
<https://alb-spirit.com/.../shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://sot.com.al/.../shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://www.tellalli.al/studiuesi-paul-heggarty-gjuhet.../>  
<https://www.ekskluzive.al/studiuesi-paul-heggarty-gjuhet.../>  
<https://ubtnews.com/tryeze-shkencore-nderkombetare.../>  
[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)



**Albanologët e huaj dhe vendës përfunduan tryezën shkencore ndërkombëtare “Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj”, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Universiteti "Ludwig Maximilian" i Mynihut**



Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë Krahasuese dhe Indoeuropiane, si dhe të Albanologjisë, pranë Universitetit “Ludwig Maximilian” të Mynihut, organizoi, më 4-5 nëntor, një tryezë shkencore ndërkombëtare për origjinën dhe lashtësinë e shqipes.

Kjo tryezë erdhi si vazhdim i rezultateve shkencore që u paraqitën në Kuvendin e Dytë të Studimeve Albanologjike, organizuar në Tiranë në nëntor të vitit 2022, me shkas nga arritjet e fundit në fushën e gjuhësisë filogjenetike indoeuropiane, të mbështetura në metoda të kombinuara ndërdisiplinore.

Fjala është në radhë të parë për artikullin e revistës amerikane “Science”, me autor të parë studiuesin gjerman Paul Heggarty (Max Planck Institute) dhe 33 bashkautorë nga disiplina të ndryshme të interesuara për këtë projekt, i cili, duke u mbështetur në të dhënat e gjuhësisë historike-krahasuese e filogjenetike dhe duke përdorur një bazë të dhënash shumë të gjerë nga të gjitha gjuhët e familjes indoeuropiane, arriti në një hipotezë të re mbi origjinën e këtyre gjuhëve dhe mbi rrugët dhe kronologjinë e përhapjes së tyre.

Kjo hipotezë e re kombinon aspekte të dy tezave të deritanishme për origjinën e gjuhëve indoeuropiane: asaj të "stepës ponto-kaspikë" dhe asaj të "gjysmëhënës pjellore" ose "hapësirës në formë gjysmëhëne", që fillon nga Deti Mesdhe e mbaron në Gjirin Persik, duke rindërtuar një teori hibride që i bashkon të dyja: pra, indoeuropeanishtja e ka origjinën në harkun verior të "gjysmëhënës pjellore" dhe vetëm disa degët e saj kryesore në Europë kaluan në veri përmes

stepës, si një pikë kalimi dytësore.



Edhe për sa i përket kohës së formimit të kësaj gjuhe, duke u mbështetur në analizat statistikore të njohura si "bayesiane" për evolucionin e fiseve, studimi arrin në një përfundim të ndërmjetëm midis dy tezave, që përcakton një origjinë 8100-vjeçare të gjuhës së përbashkët indoeuropiane, e cila, 1000 vjet më pas, filloi të degëzohet e të shpërndalet.

Studimi përfshin specifikisht edhe gjuhën shqipe, me tre variante të saj: shqipen standarde, dialektin e gegërishtes dhe arbërishten, ku analizat krahasuese dhe statistikore njoftojnë për një shkëputje të hershme 6000 vjet më parë të gjuhës shqipe.

Këto përfundime për gjuhën shqipe, një vit më parë, kur u botua artikulli në "Science", ngjallën një interes të madh në opinionin publik shqiptar, duke shkaktuar edhe përdorime popullore.

Në konferencë referoi autori kryesor i studimit të revistës "Science" për arritjet dhe rezultatet e punës së tyre, duke u përqendruar në të dhënat e shqipes.

Rikonfirmohet ndarja e hershme 6000-vjeçare e shqipes dhe kalimi i paraardhësve të shqiptarëve jo në degëzimin verior përmes stepës, por në lëvizjen lindje-perëndim drejt Gadishullit ballkanik.

Një tjetër prezantim nga një bashkëpunëtor i studimit (U. Geupel) ofroi një përmbledhje të punës praktike mbi shqipen që qëndron pas rezultateve të punimit "Heggarty et al." (2023), botuar në "Science"; si u realizua mbledhja e burimeve dhe kodimi i afërisë gjenetike për bazën e të dhënave të marrëdhënies indoeuropiane të afërisë, duke paraqitur edhe problemet specifike të shqipes në këtë studim, siç janë dëshmimi i vonë shkrimor, pasiguritë në studimin e parahistorisë së saj, prurjet e shumta të huazimeve etj.





Kumtesa të tjera vunë në dukje kontaktet parahistorike dhe përkimet gjuhësore midis dialekteve fqinjë të indoeuropianishtes, duke u përqendruar në kontaktet e hershme të dialekteve para-paleoballkanike me dialektin para-prototokarian dhe dallimet mes tyre (O. Hackstein), ose në përkimet tripalëshe shqipe-greqishte-armenishte në kontekstin e “indoeuropianishtes ballkanike”, duke e testuar këtë hipotezë nga këndvështrimi i morfologjisë dhe i semantikës, sipas materialeve të reja të "Fjalorit digital etimologjik-historik të shqipes së vjetër" (shek. XV-XVIII) të Mynihut (G. Imberciadori).

Në një tjetër referim u dhanë argumente e shpjegime në lidhje me pyetjen që bëhet për vjetërsinë e gjuhëve, duke vërejtur se, nëse vjetërsia relative e një gjuhe mund të përcaktohet në bazë të inovacioneve gjuhësore që e dallojnë nga gjuhët e tjera, vjetërsia (kronologjia) absolute nuk mund të datohet, pra, gjuhët nuk kanë një datë lindjeje, por kronologji të dallimit (shkëputjes). U diskutua gjithashtu çështja e emrit të gjuhës shqipe, kur e mori shqipja këtë emër (Michiel de Vaan).

Ndërkohë, metodat e reja në studimet gjuhësore, të kombinuara me metodat arkeologjike dhe gjenetike, u kanë dhënë shtysë projekteve të tjera për studimin e lëvizjeve të popullsisë dhe gjuhëve indoeuropiane, që janë zhvilluar e po zhvillohen në institucione të ndryshme shkencore në botë. Në konferencë u prezantua një tjetër projekt i kësaj natyre, që merr në trajtim indoeuropianizimin e Europës Juglindore (Ballkanit), duke ndjekur lëvizjet migratore me pikënisje Kaukazin verior e stepat ponto-kaspikë drejt Perëndimit e duke arritur në përfundimin, në bazë të të dhënave gjuhësore të mbështetura edhe nga gjetjet arkeologjike e metodat gjenetike, se zhvendosjet drejt Ballkanit kanë filluar përpara migrimëve masive të popullsisë indoeuropiane "Yamnaja" nga stepat. Studimi dallon një zonë konvergjence kulturore në Ballkanin qendror, që ka çuar edhe në zhvillime të përbashkëta gjuhësore mes

disa prej gjuhëve IE paraballkanike, si shqipja, armenishtja, mesapishtja, me lidhje edhe me disa dialekte të greqishtes e të frigjishtes. Punimi gjurmon rrugët e ardhjes së folësve të protoshqipes në Ballkan, të cilët qendruan në Ballkanin Qendror mbas largimit të mesapëve drejt Perëndimit dhe të armenëve drejt Lindjes (J. Matzinger, K. Ackermann).

Si dy popuj që ndajnë një substrat të përbashkët ballkanik-mesdhetar dhe kanë lidhje të hershme në "atdheun" e hershëm ballkanik, grekët dhe shqiptarët kanë elemente të përbashkëta kulturore, por edhe dallime, siç është figura mitologjike e gjarprit / dragoit, e cila u trajtua në një nga kumtesat e tryezës (Dh. Qiriazi).

Ndër dukuritë e përbashkëta gjuhësore që ndajnë gjuhët e "Lidhjes gjuhësore ballkanike" ("Balkan Sprachbund") mjaft interesante është nyja e prapme shquese që haset në gjuhën shqipe, rumanishte, bullgarishte e maqedonishte. Autori i kumtesës përqendrohet në burimin e kësaj dukurie në këto gjuhë dhe e kërkon të shqipja pikënisjen e këtij procesi ose rolin ndihmës në përhapjen e tij (A. Spiro).



Një çështje tjetër ishte receptimi ose pritja e artikullit të revistës "Science" në debatin publik dhe në media në mjediset shqiptare (A. Vehbiu) dhe në ato të sferës balto-sllave (M. Majer).

Një temë me interes erdhi nga fusha e fonetikës eksperimentale, që mat evolucionin dhe ndryshimin gjuhësor me metoda kompjuterike, duke sjellë për herë të parë zbatimin e metodës së "modelimit me bazë agentësh" (MBA) në të dhënat e gjuhës shqipe. Punimi argumenton se modele si ky MBA, që përfshin si faktorë të brendshëm gjuhësorë ashtu edhe faktorë të jashtëm, mund të riprodhojnë me sukses evolucionin dhe ndryshimin gjuhësor në kohë dhe hapësirë (E. Kapia, J. Riverin).

---

Një grup kumtesash nga fusha e arkeologjisë dhe gjenetikës paraqiten rezultate nga gjetjet arkeologjike në territoret e Shqipërisë, si vendbanimet palafite të Linit, më të vjetrat në Europë; ose vendbanimi parahistorik i Maliqit me evidenca të tjera arkeologjike në Shqipëri dhe Kosovë, që dëshmojnë se nga bashkëjetesa e popullsisë vendase eneolitike (paraindoeuropiane) dhe asaj migracionere të "bronzit të hershëm" (indoeuropiane), që në mijëvjeçarin III para Kr. fillon procesi i gjatë i etnogjenezës së popullsisë ilire në Ballkanin Perëndimor.

Risi e kësaj tryeze janë studimet e kryera me metoda të reja të kombinuara ndërdisiplinore, që nga njëra anë konfirmojnë rezultatet e arritura prej kohësh nga gjuhësia historike-krahasuese indoeuropiane dhe nga ana tjetër bëjnë hapa përpara në drejtim të saktësimin të kronologjisë relative të dallimit të gjuhëve nga trungu i përbashkët indoeuropian, duke hapur edhe shtigje për kërkime të mëtejshme e debate shkencore. Si një nga gjuhët e shkëputura herët nga ky trung i përbashkët, konfirmohet gjuha shqipe si një nga gjuhët më të lashta në Ballkan, ardhur ndoshta drejtpërdrejt nga rajoni anatolian (Heggarty et al.) ose nga stepat pontike (Matzinger, Ackermann et al.).

Në mbyllje tryeza u vlerësua një sukses cilësor dhe shprehje e avantazheve që ofron bashkëpunimi midis albanologëve dhe qendrave e institucioneve kërkimore të tyre.

Shih dhe lajmet për veprimtarinë të pasqyruara në media:

<https://ata.gov.al/.../mbyllet-tryeza-shkencore-dedikuar.../>

<https://it.ocnal.com/.../esplorando-le-radici-antiche...>

<https://albaniantimes.al/albanian-language-age-controversy/>

<https://lajme.rtsh.al/.../origjina-e-shqipes-6000-vite-me...>

<https://albanianeducation.net/gjuha-shqipe-6000-vjecare.../>

<https://historiashqiptare.net/gjuha-shqipe-daton-6-mije.../>

<https://koha.mk/gjuha-shqipe-6000-vjecare-mbahet.../>

<https://www.arsalbanica.mk/shqipja-ne-tri-me-te-vjetrat.../>

<https://www.gazetatema.net/.../origjina-e-shqipes-6000...>

<https://pamfleti.net/.../gjuha-shqipe-6000-vjecare-mbahet...>

<https://ata.gov.al/.../origjina-e-shqipes-6000-vite.../>

<https://euronews.al/gjuha-shqipe-6000-vjecare-mbahet.../>

<https://euronews.al/.../6000-year-old-albanian-language.../>

<https://americaneye.al/gjuha-shqipe-daton-4-mije-vjet-me.../>

<https://gazetadita.al/gjuha-shqipe-6000-vjecare-mbahet.../>

<https://www.ekskluzive.al/studiuesi-paul-heggarty-gjuhet.../>

<https://kosovaimetv.com/gjuha-shqipe-6000-vjecare-mbahet.../>

<https://www.gazetatema.net/.../tryeze-shkencore...>

<https://www.kultplus.com/.../mbyllet-tryeza-shkencore.../>

<https://frekuenca.net/.../45363-origjina-e-shqipes-6000...>

<https://fax.al/.../gjuha-shqipe-6000-vjecare-mbahet...>

<https://stop.tvklan.al/origjina-e-shqipes-7000-7500.../>



---


<https://www.voxnews.al/.../gjuha-shqipe-daton-4-mije-vjet...>  
<https://startnews.news/.../video-shqipja-daton-6-mije.../>  
<https://www.ekskluzive.al/studiuesi-paul-heggarty.../>  
<https://a2news.com/.../gjuhet-indoeuropiane-lashtesia-e...>  
<https://ubtnews.com/tryeze-shkencore-nderkombetare.../>  
<https://www.tellalli.al/studiuesi-paul-heggarty-gjuhet.../>  
<https://alfapress.al/.../gjuha-shqipe-6000-vjecare-mbahet...>  
<https://youtu.be/XkVjSlkFEMs?si=zf0Y3XcDsehQdY0t>  
<https://revokult.com/.../origjina-e-shqipes-6000-vite-me.../>  
<https://medial.mk/origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes-shqipe.../>  
<https://www.gazetatema.net/.../fjale-pershendetese-e.../>  
<https://cnn.al/.../origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes.../>  
<https://youtu.be/XkVjSlkFEMs?si=WArEUQT7jt2GojJ7/>  
<https://www.youtube.com/watch?v=y9mm8qz9p4M/>  
<https://zhurnal.mk/origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes.../>  
<https://medial.mk/origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes-shqipe.../>  
<https://youtu.be/y9mm8qz9p4M?si=gAmoIWJ7FTF39mfH>  
<https://ata.gov.al/.../shqipja-midis-gjuheve.../.../>  
<https://youtu.be/XkVjSlkFEMs?si=oSjTizt5EPyC2eS8>  
<https://albanian.cri.cn/.../ARTIhIEvn9Xt8b5uWuVIE0Zn2411.../>  
<https://a2news.com/.../gjuhet-indoeuropiane-lashtesia-e.../>  
<https://youtu.be/bE15b3MyvNQ?si=9HL3M8gHs640h1kn>  
<https://www.youtube.com/watch?v=y9mm8qz9p4M>  
<https://telegafi.com/origjina-dhe-vjetersia-e-gjuhes.../>  
<https://www.kultplus.com/.../shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://www.oranews.tv/.../shqipja-ne-tri-me-te-vjetrat.../>  
<https://alfapress.al/.../studiuesi-paul-heggarty-gjuhet.../>  
<https://observerkult.com/shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://ubtnews.com/tryeze-shkencore-nderkombetare.../>  
<https://frekuenca.net/.../45100-shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://www.mcntv.al/node/208771>  
<https://alb-spirit.com/.../shqipja-midis-gjuheve.../>  
<https://sot.com.al/.../shqipja-midis-gjuheve.../>  
[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

## KUVENDI KOMBËTAR PËR GJUHËN SHQIPE “Sfidat e Gjuhës Shqipe në shekullin XXI”

Akad. Gjinushi: -“Detyra e Akademisë së Shkencave dhe e specialistëve të fushës është mirëmbajtja, përmirësimi e promovimi i saj në vazhdimësi, pasi gjuha është në zhvillim të vazhdueshëm, ndërsa detyra e çdo qytetari është mirëpërdorimi i gjuhës e veçanërisht i shkollës dhe i folësve publikë.”-

-Fjalë përshëndetjeje e Kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi-



Sot, më 21 nëntor 2024, në ceremoninë e çeljes së Kuvendit Kombëtar për Gjuhën Shqipe me temë “Sfidat e gjuhës shqipe në shekullin XXI”, akad. Skënder Gjinushi, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë mbajti një fjalë përshëndetëse.

Kuvendi që do të mbahet për dy ditë rresht zhvillohet me rastin e Ditës së Alfabetit, festës mbarëkombëtare të gjuhës shqipe.

Në emër të ASHSH, akad. Gjinushi ka përshëndetur e mbështetur nismën e Qeverisë për shpalljen e vitit 2024 Vit të Gjuhës Shqipe, që u bë pjesë e një kalendari mbarëkombëtar: në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut, në Arbërinë e arbëreshëve e në Mal të Zi, në ngulimet historike e në diasporë.

---

Më poshtë, fjala e plotë e akad. Skënder Gjinushit, Kryetar i ASHSH:

"I nderuar z. Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë;

E nderuar znj. Manastirliu, Ministre e Arsimit dhe Sporteve;

E nderuar znj. Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës;

Të nderuar të pranishëm: akademikë e profesorë, studiues të gjuhës shqipe dhe të trashëgimisë kombëtare;

Ju uroj gëzuar Ditën e Alfabetit, festën mbarëkombëtare të gjuhës shqipe, në emër të Akademisë së Shkencave, që sivjet, për herë të parë, kremtohet zyrtarisht në tri shtete dhe nderohet gjithashtu me status të njohur ligjor edhe në dy shtete të tjera.

Gëzuar mësuesve të shqipes, shkrimtarëve, përdoruesve publikë dhe gjithë shqiptarëve e shqipfolësve.

Akademia e Shkencave, si një institucion me mision kryesor zhvillimin, përrurimin, mbrojtjen nga keqpërdorimi dhe përparimin e shqipes sonë të përbashkët, e ka përshëndetur e mbështetur nismën e Qeverisë për shpalljen e vitit 2024 Viti i Gjuhës Shqipe, që u bë pjesë e një kalendari mbarëkombëtar: në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut, në Arbërinë e arbëreshëve e në Mal të Zi, në ngulimet historike e në diasporë.

Siç dihet, zgjedhja e datës 22 nëntor, si dita e gjuhës, është bërë në nderim të vendimeve të Kongresit të Manastirit.

Pa njësimin e alfabetit dhe latinizimin e shkrimit, të vendosura aty, nuk mund as të kuptohet, as të përfytyrohet rruga historike që ndoqi gjuha shqipe përgjatë një shekulli e më shumë që nga viti 1908.

Kombi shqiptar u formua dhe shteti shqiptar u pavarësua përmes kontributit të shoqërive atdhetare, klubeve kulturore e lëvizjeve mendore e vendimeve të marra në kongrese e evente si ai i Manastirit.

Iluminizmi e Rilindja shqiptare, për dallim prej shumë vendeve të tjera, kanë lindur e janë zhvilluar kryesisht si iluminizëm gjuhësor, sepse gjuha ka qenë tipari bazë i identitetit të kombit shqiptar; kombi ynë ka mbijetuar prej gjuhës dhe përmes gjuhës. Shqiptarët patën mençurinë që, përkundër dallimeve të shumta mes tyre: etnografike e dialektore, fetare e kulturore, shtuar dhe ato të diktuar nga kufijtë gjeopolitikë e padrejtësitë historike, të zgjedhin si faktorin më të rëndësishëm përdallues, gjuhën kombëtare.

Prandaj dhe shqiptarët e komuniteti shkencor kanë qenë e janë mjaft të ndjeshëm ndaj origjinës e lashtësisë së gjuhës amtare. Për këtë arsye, brezi i gjuhëtarëve të pas çlirimit, një brez i formuar në universitete të mirënjohura europiane, me Eqrem Çabejn si emblemë të tij, iu përkushtua studimit të gjuhës, duke themeluar shkollën vendëse të albanologjisë pranë Akademisë së Shkencave, shkollë tashmë e njohur dhe vlerësuar ndërkombëtarisht, çka bëri, siç thoshte profesori, që albanologjia të vinte e mbetet në shtëpinë e saj.

Tezat e formuluar e provuara nga kjo plejadë studiuesish e akademikësh për lashtësinë e shqipes, për origjinën e saj indoeuropiane, për lidhjen e saj me ilirishten, jo vetëm i kanë

---

qëndruar kohës, por ato janë pasuruar e rikonfirmuar së fundi edhe nga studimet më të reja në gjuhësinë europiane, të mbështetur në metoda filogjenetike dhe në rindërtimin e ADN-së së gjuhëve indoeuropiane, të cilat mundësojnë të përcaktohet jo vetëm qenia e shqipes si degë më vete, por edhe koha e fillimit të shkëputjes së saj 6 mijë vjet më parë, si dhe drejtimi i rrugëtimit të paraardhësve tanë drejt Europës.

Artikulli më i komentuar i Paul Hagerti me 33 bashkautorë, të Institutit të mirënjohur "Max Planck" dhe të disa qendrave akademike dhe universitare, paraqitur në konferencën e organizuar në Tiranë me Universitetin e Mynihut, këto rezultate i nxori duke u mbështetur në fjalë-çelës, të zgjedhura nga studimet e botimet shkencore të Çabejt dhe të gjuhëtarëve të tjerë të atij brezi e jo nga burimet diletante e amatoreske. Dhe këto janë lajme të mira për shkencën dhe gjuhën shqipe.

Të njëjtat rezultate përkojnë e konfirmohen edhe nga studimet e bazuara mbi ADN-në e popullatave e gjetjet arkeologjike ndër vite, të cilat dëshmojnë lashtësinë e vijimësinë e popullimit të rajonit tonë që prej 8 mijë vjetësh.

Këto studime nuk flasin për supremaci të një gjuhe ndaj të tjerave, as të një popullsie ndaj të tjerave, por i japin shqipes e shqiptarëve, historisë së tyre, vendin që iu takon; tregojnë gjithnjë e më qartë rrugëtimit e formimit të etnosit shqiptar e gjuhës shqipe, krahas e në dallim me gjuhët e popujt e tjerë, shkallën e ndërthurjes midis ardhësve e vendësve, e ky proces 6 mijë vjeçar, me zanafillë parailire e parapellazge ka dhënë këtë gjuhë të mrekullueshme me të cilën Kadare diti të shkruajë kryevepra botërore, dëshmi kjo e pasurisë së saj.

Ne të gjithëve na takon ta mbrojmë këtë pasuri e vlerë kombëtare. Së pari, ta mbrojmë nga vetja, nga keqpërdorimi a mospërdorimi. E këtu vlen të theksohet rëndësia që ka gjuha standarde, tregues ky i një stadi të avancuar të zhvillimit të kulturës e gjuhës së një kombi. Ashtu si intelektualët e mendimtarët e Rilindjes dhe Pavarësisë ditën të kuptojnë rëndësinë e të bëjnë kompromisin për një alfabet të unifikuar, ashtu dhe brezi i intelektualëve shqiptarë, këtu e në Kosovë, iu përgjigjën nivelit historik të ndërjegjes kombëtare duke përgatitur Kongresin e Drejtshkrimit më 1972-shin, duke marrë vendimin e bërë kompromisin për një shqipe të njësuar letrare.

Detyra e Akademisë së Shkencave dhe e specialistëve të fushës është mirëmbajtja, përmirësimi e promovimi i saj në vazhdimësi, pasi gjuha është në zhvillim të vazhdueshëm, ndërsa detyra e çdo qytetari është mirëpërdorimi i gjuhës shqipe e veçanërisht i shkollës dhe i folësve publikë.

Gjuha duhet mbrojtur dhe nga humbja e folësve të saj. Këtu, ne, mbështesim Ministrinë e Arsimit për të nxitur e organizuar mësimin e gjuhës shqipe nga shqiptarë të larguar, a lindur jashtë vendit. Ne vlerësojmë se programet e mësimin të gjuhës në shkolla duhet të jenë sa më profesionale e lehtësisht të kapshme nga nxënësit dhe Instituti ynë e ka për detyrë e është i gatshëm të kontribuojë në përmirësimin e tyre, por edhe vetë familjet shqiptare duhet ta transmetojnë këtë gjuhë të vyer.

Sigurisht, për këto do të flasin specialistët me më kompetencë, prandaj, dhe një herë, i

---

uroj punime të mbara këtij kuvendi për gjuhën tonë, organizuar me mjaft kujdes prej Ministrisë së Arsimit.

Faleminderit për vëmendjen."

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)



---

## Akademia e Shkencave prezanton projektin e veprës “Fjalori i madh i gjuhës shqipe”

-Dita e dytë e Kuvendit Kombëtar për Gjuhën Shqipe: “Sfidat e Gjuhës Shqipe në shekullin XXI”-

-Fjalë përshëndetjeje e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë-

Akad. Skënder Gjinushi: Për hartimin e veprës “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” u ngrit një grup i përbërë nga 55 bashkautorë e 25 hartues, të drejtuar nga një redaksi prej 10 leksikografësh e në ndihmë të saj u krijua një qendër e posaçme, ajo e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, tashmë e kthyer në qendër të përhershme, si një organ administrativ e profesional. U ngrit një trupë e krahasueshme me dy institute; Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë ka sot 21 punonjës kërkimorë-shkencorë.-



Sot më 22 nëntor 2024, një ditë pas çeljes së Kuvendi Kombëtar për Gjuhën Shqipe më temë: “Sfidat e Gjuhës Shqipe në shekullin XXI”, u prezantua projekti i veprës “Fjalori i madh i gjuhës shqipe”.


Prezantimi u bë në Ditën e Alfabetit të Gjuhës Shqipe.

Kuvendi u çel, dje, më 21 nëntor 2024, me pjesëmarrjen e gjerë të akademikëve gjuhëtarëve, pedagogëve e mësuesve të gjuhës shqipe nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia e Veriut.

Sot me rastin e prezantimit të projektit të veprës “Fjalori i madh i gjuhës shqipe”,

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi mbajti një fjalë përshëndetëse, në të cilën shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e tij për drejtuesit e projektit, autorët e bashkëpunëtorët e veprës, të cilët bënë një punë sfiduese 4-vjeçare të ndërmarrë nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim me të gjitha institucionet e kësaj fushe në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, etj.

Akad. Gjinushi shprehu mirënjohjen dhe falënderimet edhe për qeverinë dhe Kryeministrin Edi Rama që ia besoi Akademisë së Shkencave dhe financoi këtë projekt madhor, duke mundësuar fillimin e punës e kryerjen me kompetencë e në kohën e duhur të kësaj vepre madhore.



Projekti i veprës “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” nisi në kuadër të reformimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, së bashku me dy projektet e tjera madhore “Enciklopedia shqiptare” dhe “Historia e shqiptarëve”.

\*

Fjalë përshëndetjeje në ditën e dytë të Kuvendit Kombëtar për Gjuhën Shqipe  
Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe

Sot, në Vitin e Gjuhës Shqipe, në ditët e Alfabetit, kemi kënaqësinë të paraqesim "Fjalorin e madh të gjuhës shqipe", vepër e një pune 4-vjeçare, të ndërmarrë nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim me tërë institucionet e kësaj fushe në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut.

Nevoja për një fjalor të madh të shqipes kish lindur me kohë. Shqipja ishte ndër gjuhët e pakta që i mungonte një fjalor i tillë.

Akademia, në kuadër të reformimit të saj, ku një nga synimet kryesore ishte kthimi në

---

një institucion aktiv të kërkimit e studimeve shkencore e jo mbetja thjesht si një institucion honorifik e në kryerje të një prej misionëve e detyrave të saj kryesore: si nxitëse e koordinuese e kërkimit shkencor, veçanërisht në fushën e albanologjisë, zgjodhi të ideojë e drejtojë tri projekte madhore në këtë drejtim, përfshirë dhe hartimin e "Fjalorit të madh të gjuhës shqipe".

Për ndërmarrjen e këtyre iniciativave ajo bashkëpunoi me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, duke e përfshirë atë në protokollin e përbashkët.



Fillimi i punës e konturimi i projektit u mbështet mbi përvojën e hershme historike të Akademisë së Shkencave, Institutit të Gjuhës dhe të Letërsisë e departamentit të gjuhës në hartimin e një sërë fjalorësh deri tek ai i mesëm i vitit 1980.

Për këtë, hartimi i platformës paraprake iu besua akademik Jani Thomait e akademik Valter Memishës, drejtor i Institutit të Gjuhësisë e kryetar i Komisionit të përhershëm të gjuhës dhe letërsisë në atë kohë.

Për të hartuar këtë vepër u ftuan gjithë specialistët e fushës në trojet shqiptare e Arbëri, përgjigjja e gatishmëria e tyre, si dhe e qeverisë dhe Kryeministrit, për të na besuar e financuar këtë projekt madhor, mundësoi fillimin e punës e kryerjen me kompetencë e në kohën e duhur të kësaj vepre madhore.

Për hartimin e saj u ngrit një grup i përbërë nga 55 bashkautorë e 25 hartues, të drejtuar nga një redaksi prej 10 leksikografësh e në ndihmë të saj u krijua një qendër e posaçme, ajo e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, tashmë e kthyer në qendër të përhershme, si një organ administrativ e profesional.

Pra, u ngrit një trupë e krahasueshme me dy institute; Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë ka sot 21 punonjës kërkimorë-shkencorë.

---

Kjo, përbëhet nga punonjësit akademikë të Institutit Albanologjik të Prishtinës, Universitetit të Prishtinës, të Tiranës e universitetet e tjera publike në Shqipëri e Maqedoninë e Veriut si dhe të Universitetit të Palermos e të Kozencës.

Për hartimin e tij u krijua një bazë të dhënash elektronike me një fond prej 800 milion njësish, në të cilat u përfshinë gjithë fjalorët e mëparshëm e veprat e autorëve më në zë shqiptarë nga Buzuku, Fishta, e deri tek Kadareja, si dhe u krijua njësi me specialistë IT dhe të gjuhësisë kompjuterike për të mundësuar hartimin e tij sipas teknologjive më të përparuara të kohës.

Fjalori i madh nuk plotëson vetëm këtë detyrë e përgjegjësi të marrë nga Akademia e Shkencave e gjuhëtarëve, nën drejtimin e akad. Thomait e Memishës, por, përvoja e fituar, baza e të dhënave e krijuar mundëson jo vetëm mbarëvajtjen e tij të vazhdueshme e pasurimin e tij sipas zhvillimit të gjuhës sonë, por vazhdimin e punës për krijimin e thesarit të shqipes; këtë rol ka qendra e re e leksikografisë e themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave e të Asamblesë.

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**



## Fjala e Kryetarit të ASHSH në promovimin e librit "Përrallëtarët e gjuhës shqipe" i autorit Ardian Vehbiu, anëtar i jashtëm i ASHSH

- Akad. Gjinushi: Akademia e Shkencave ka formuluar, vërtetuar e mbrojtur, që nga Buda e Çabej, lashtësinë e origjinën e gjuhës e të popullit shqiptar -
- Akad. Gjinushi: Zbulimet arkeologjike më të fundit, artikulli në revistën "Science", futja e metodave dhe teknologjive të reja, kanë konfirmuar e datuar lashtësinë e origjinën e gjuhës e të popullit shqiptar në 6-8-mijëvjeçare -



Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, në promovimin e librit të Adrian Vehbiut, përshëndeti e përgëzoi autorin për kurajën e treguar me këtë botim.

Akad. Gjinushi theksoi se libri duket se polemizon me abuzuesit e historisë së gjuhës dhe të popullit, por ka edhe kritikë konstruktive brenda vetes për Akademinë e botën akademike në tërësi: që ato të shprehin qartë e më me forcë qëndrimin për këto çështje sensitive, siç janë



lashtësia e origjina e gjuhës dhe e popullit shqiptar.

Duhet të jetë e qartë për opinionin e gjerë se është albanologjia, janë specialistët e anëtarët e Akademisë së Shkencave, që kanë formuluar tezën e lidhjes së gjuhës shqipe me ilirishten, të prejardhjes së shqiptarëve prej ilirëve e për përkatësinë e gjuhës shqipe si gjuhë indoeuropiane me origjinë mijërvjeçare.

Këto teza të Kuvendit të Parë të Studimeve Ilire më 1972-shin janë rikonfirmuar ndër vite dhe në Kuvendin e Dytë, 3 vjet më parë. Ky promovim po bëhet kur sapo ka përfunduar konferenca shkencore ndërkombëtare dyditore, ku, nga studimet e paraqitura, veçanërisht prej Heggarty-t, autor i artikullit botuar në revistën "Science" më 2023-shin, rikonfirmohet jo vetëm origjina 8-mijëvjeçare, por përcaktohet edhe koha e shkëputjes a dallimit të shqipes nga trangu indoeuropian 6 mijë vjet më parë, si dhe rrugëtimi i paraardhësve të shqiptarëve drejt Ballkanit nëpërmjet lëvizjes nga lindja në perëndim dhe jo prej ardhjeve veriore, nga stepat.



Këto rezultate rikonfirmohen edhe nga studimet mbi bazën e ADN-së së popullatave indoeuropiane nga 8 mijë vjet më parë deri më sot. Në këto rezultate kanë kontributit studimet shqiptare, të akademik Çabejt e kolegëve të tij, pasi profesor Heggarty si model të shqipes zgjodhi 150 fjalë të marra nga studiuesit tanë e jo nga ato që keqpërdoren në opinion e me to provoi se shqipja filloi të identifikohet si degë më vete 6 mijë vjet më parë.

Pra, duhet të kuptohet nga opinioni se lashtësia dhe origjina e shqipes dhe shqiptarëve është mbrojtur e provuar prej ASHSH e albanologjisë shqiptare në bashkëpunim me qendrat albanologjike shkencore; se këto teza janë bërë të pranueshme edhe jashtë jo prej deklarimeve

---

e llafollogjisë mediatike, por prej studimeve e provave shkencore. Zbulimet arkeologjike ndër vite, gjithashtu, kanë përforcuar këto teza, sepse ato tregojnë se rajoni ynë, territori shqiptar, ka qenë banuar 8 mijë vjet më parë, se kulturat materiale kanë një zhvillim të pandërprerë etj.

Debatin ne nuk e kemi me përrallëtarët, siç thotë autori, për sa i takon lashtësisë e vjetërsisë, por me opinionin publik, që të kuptojë se Akademia e Shkencave jo vetëm i mbron këto teza, por është ajo që i bëri të pranueshme nga të tjerët që në vitet 1972, kur teza të kundërta deri antishqiptare ishin dominuese edhe në qarqe shkencore.

Ne, ndryshe nga ata, vërejmë se jo vetëm akuzohet a kritikohet Akademia e Shkencave e gjuhëtarët e arkeologët shqiptarë në tërësi pa të drejtë, por, duke i keqpërdorur këto teza, duke u përpjekur për protagonizëm, amatorizëm a dashakeqësi, duke i provuar ato me argumente joshkencore e duke nxjerrë prej tyre konkluzione të pabaza, i bëjnë ato të pabesueshme e deri qesharake, duke u dhënë armë të tjerëve t'i vënë në dyshim a t'i ridikulizojnë ato.

Pra, Akademia nuk duhet të rrijë në "mbrojtje", por të marrë meritat që i takojnë, meritat e shkollës së Çabejt së pari. Metodatat e teknologjitë e reja mbështetur mbi inteligjencën artificiale a studimin e ADN-së po provojnë gjëra që s'mund të bëheshin më parë. Ne nuk kemi nevojë të gënjejmë, as të zbukurojmë, as të sajojmë fakte a t'i shtrembërojmë. Mjaftojnë të vërtetat që u thanë gjatë konferencës nga ajka e albanologjisë botërore, e cila duke pranuar dhe mbrojtur këto teza flet vetë me shume se tërë llafollogët.

Shih dhe:

<https://www.oranews.tv/.../perralletaret-e-gjuhes-shqipe...>

<https://www.gazetatema.net/.../promovohet-ne-sallen-aleks...>

<https://www.gazetatema.net/.../ardian-vehbiu-vjen-me...>

<https://frekuenca.net/.../45411-promovohet-ne-sallen...>

<https://mekulipress.com/perralletaret-e-gjuhes-shqipe.../>

<https://www.youtube.com/watch?v=JZvSUCB4iig>

<https://shqiptarja.com/.../albanologjia-ne-rrezik...>

<https://www.kultplus.com/.../perralletaret-e-gjuhes.../>

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

## Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Horizonti AI - një epokë e re kreativiteti dhe inovacioni”

-Marrin pjesë rreth 80 akademikë, studiues dhe shkencëtarë të njohur nga vendi dhe Bota, që janë përkushtuar në avancimin e fushës së inteligjencës artificiale. Prezantohen 40 punime shkencore-



Më 8 nëntor 2024, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike dhe Njësia e inteligjencës artificiale pranë kësaj akademie zhvilluan konferencën ndërkombëtare me temën “Horizonti AI - një epokë e re kreativiteti dhe inovacioni”.

Veprimtaria u çel në Tirana Marriott Hotel me praninë fizike dhe online të rreth 80 akademikëve, studiuesve dhe shkencëtarëve të njohur që janë përkushtuar në avancimin e fushës së inteligjencës artificiale nga Shqipëria, Finlanda, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Franca, Greqia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Turqia, etj.

Seanca plenare u hap nga prof. dr. Kozeta Sevrani, e cila iu uroi të pranishmëve mirëseardhjen në emër të Akademisë së Shkencave.

Ajo foli për qëllimin e konferencës, që është të inkurajojë dialogun dhe të ndërtojë rrjete që do të nxisin progres dhe inovacion në fushën e AI, duke eksploruar dhe shfrytëzuar të gjitha potencialet e AI, por dhe të gjitha ato sfida lokale e globale që mbart me vete kjo risi teknologjike. AI mund të jetë një mjet për kreativitetin, inovacionin dhe zgjidhjen e problemeve komplekse, cilado qofshin fushat e aplikimit të saj.

Në fund të fjalës së saj, ajo falënderoi në mënyrë të veçantë Kryetarin e ASHSH, akad.

Skënder Gjinushin, për ideimin, mbështetjen dhe interesimin e vazhdueshëm në krijimin e Njësisë së IA, por edhe për mbarëvajtjen e kësaj konference, si dhe bashkëpunëtorët e konferencës. Gjithashtu prof. dr. Sevrani përshëndeti grupin organizator: akad. Neki Frashërin e akad. Arian Durrësin, prof. dr. Betim Çiçon, prof. dr. Elinda Kajon, etj.

Kryetari i ASHSH, akad. Skënder Gjinushi përshëndeti pjesëmarrësit dhe foli për rëndësinë e kësaj konference. Ai theksoi se “Qëllimi i Akademisë së Shkencave e misioni i saj është nxitja e mbështetja e kërkimit shkencor, jo në bashkëpunim, por së bashku me Institucionet e Arsimit të Lartë e të gjitha institucionet e kërkimit shkencor.



“Njësitë e ngritura pranë Akademisë së Shkencave e komisionet e përhershme, siç janë edhe Njësia e Inteligjencës artificiale dhe komisioni i matematikë-informatikës janë në shumicë dërrmuese, në përbërje, me profesorë, doktorë shkencash, punonjës shkencorë të shollave të larta. Të gjitha projektet e ndërmarra nga ASH e njësitë e saj ideohen e kryhen së bashku.” - tha akad. Gjinushi.

Akad. Gjinushi foli edhe për objektivin kryesor të ligjit për shkencën. Ai tha se “Ligji i ri synon të vendosë një dialog qeveri-shkencë, për të rritur interesin për shkencën, gjë që nuk është shprehur siç duhet, megjithatë shpresojmë të shërbejë si një hap para.”.

Konferencën e përshëndetën znj. Elsa Dhuli, drejtoreshë e përgjithshme e Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT); Enio Kaso, drejtor për Inteligjencën Artificiale pranë agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe rektori i UBT-së, Kosovë, prof.



dr. Edmond Hajrizi. Ata shprehën falënderimet për bashkëpunimin e vazhdueshëm me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe vunë theksin në domosdoshmërinë e bashkëpunimit për të avancuar zhvillimin e teknologjive të inteligjencës artificiale.

Seanca e parë e konferencës u drejtua nga akad. Arjan Durrësi, akad. Neki Frashëri.



Në ditën e parë të kësaj konference u paraqitën 40 punime shkencore, ku u trajtuan çështje të tilla, si vështrimi matematikor mbi inteligjencën artificiale, përmirësimi i një sistemi të menaxhimit të mësimi (LMS) me personalizimin e drejtuar nga AI-ja; kërkimi shumëvjeçar i dizajnit të veprimit mbi zhvillimin e platformës me kod të ulët, duke përdorur gjuhë specifike për domenin; hulumtimet më të fundit mbi AI-në në Ballkanin Perëndimor; zhvillimet aktuale të sistemit bazuar në AI në Ubt Smart City, etj.

Veprimtaria vijon edhe sot, më 9 nëntor 2024, gjatë gjithë ditës.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)



---

## Fjala e Kryetarit të ASHSH akad. Gjinushi në konferencën ndërkombëtare “Horizonti AI - një epokë e re kreativiteti dhe inovacioni”

- Akad. Gjinushi: Qëllimi i Akademisë së Shkencave e misioni i saj është nxitja e mbështetja e kërkimit shkencor, jo në bashkëpunim, por së bashku me institucionet e arsimit të lartë e gjithë institucionet e kërkimit shkencor. Të gjitha projektet e ndërmarra nga ASHSH e njësitë e saj ideohen e kryhen së bashku.



Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi në konferencën ndërkombëtare “Horizonti AI - një epokë e re kreativiteti dhe inovacioni”, që u mbajt më 8 nëntor 2024 në Tirana Marriott Hotel, me pjesëmarrjen 80 akademikëve, studiuesve dhe shkencëtarëve të njohur nga vendi dhe Bota përshëndeti pjesëmarrësit dhe foli për rëndësinë e kësaj konference, si dhe për nxitjen dhe mbështetjen e kërkimit shkencor nga ASHSH-ja në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë e të gjitha institucionet e kërkimit shkencor.

Fjala e plotë e akad. Skënder Gjinushit, Kryetar i ASHSH:

“Kjo konferencë zhvillohet në dy momente të veçanta:

- në një kohë kur sistemi i kërkimit shkencor tek ne kërkon të ringrihet e të rikstrukturohet me qëllim rritjen e kapaciteteve intelektuale e logjistike në kërkimin shkencor nëpërmjet rritjes së investimeve e krijimit të kushteve për thithjen e tyre, në mënyrë që

Shqipëria t'u afrohet standardeve e treguesve europian.

- në një kohë kur Inteligenca Artificiale është kthyer në përcaktuesen e shkallës së zhvillimit të një vendi, jo vetëm në fushën e shkencës, por në të gjitha fushat e jetës, ekonomi, bujqësi, industri e deri edhe në fushën e mbrojtjes.



- Ne, trashëgojmë një prapambetje relative të ndjeshme në të gjithë treguesit. Reforma e Akademisë së Shkencave këtë synon, mbas reformimit të vetes, ajo punon për reformimin e sistemit të kërkimit shkencor.

- Ligji i ri për shkencën është një hap në këtë drejtim, por, fatkeqësisht, ai nuk arriti parametrat e duhura.

- Ndër risitë e tij është vendosja e bazës ligjore për të institucionalizuar bashkëpunimin ndërmjet Akademisë së Shkencave, njësive të saj me universitetet e institutet e tjera. Por përcaktimet për këtë bashkëpunim mund e duhet të ishin më të qarta në frymën e shkencës së hapur, ca më tepër që ky bashkëpunim, nga disa, shihet me rezerva e pesimizëm.

Qëllimi i Akademisë së Shkencave e misioni i saj është nxitja e mbështetja e kërkimit shkencor, jo në bashkëpunim por së bashku me institucionet e arsimit të lartë e gjithë institucionet e kërkimit shkencor.

- Njësitë e ngritura pranë Akademisë së Shkencave e komisionet e përhershme, siç janë edhe Njësia e Inteligjencës artificiale dhe komisioni i matematikë-informatikës janë në shumicë dërrmuese, në përbërje, me profesorë, doktorë shkencash, punonjës shkencorë të shollave të

larta. Të gjitha projektet e ndërmarrë nga ASHSH e njësitë e saj ideohen e kryhen së bashku.

- Vetë kjo konferencë, ky organizim, ky bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, lista e kumtuesve, niveli i tyre flet për domosdoshmërinë e efikasitetin e këtij bashkëpunimi e tregon se tek ne nuk mungojnë kapacitet intelektual, por ato duhen konsideruar e mbështetur, se, të gjithë ju e vlerësoni dhe e kërkonin këtë bashkëpunim, e kuptoni nevojën e vendosjes së një komunikimi e debati ndër specialistë, nevojën e ndërmarrjes së projekteve të përbashkëta e të krijimit të kushteve, që edhe kolegët tanë jashtë vendit të japin kontributin e tyre, ndryshe nga tendencat lokaliste, vërejtur gjatë miratimit të ligjit e të shprehura vend e pa vend në ligj.

Koordinimi i sistemit të kërkimit me bazament në shkollat e larta dhe institutet duhet të qe gjuha e objektivi kryesor i ligjit.



- Ligji i ri synon të vendosë një dialog qeveri-shkencë, për të rritur interesin për shkencën, gjë që nuk është ka shprehur siç duhet, megjithatë shpresojmë të shërbejë si një hap para.

Për t'u kthyer tek konferenca juaj; Inteligjenca Artificiale ka bërë që interesi për shkencën të rritet, që avantazhet e teknologjive e reja të jenë të prekshme nga të gjithë: të parit që i themi mirëmëngjes është celulari, pastaj..

Këto ditë u organizua konferenca ndërkombëtare për albanologjinë ku u panë përparësitë e teknologjive të reja në albanologji e gjenetikë.

- Nëpërmjet saj tani studiohet ecuria e evoluimi si i gjuhëve indo-europiane, ashtu dhe i popujve indo-europianë në mijëvjeçar - duke konfirmuar këtë origjinë të popullsisë europiane dhe asaj shqiptare, duke përcaktuar edhe datat e rrugëtimit drejt Europës 7.000 e 5.000 vjet më parë, përkatësisht nga Lindja e veriu, nga Anadulli e nga stepat, si dhe kur kanë filluar të identifikohen gjuhët që kanë mbijetuar, nga ku shqipja rezulton se është shkëputur 6.000 vjet



më parë si degë më vete, e se rrugëtimi i paraardhësve tanë për t'u vendosur në Ballkan ka nisur në atë kohë edhe studimet gjenetike të kombinuara me inteligjencën artificiale kanë konfirmuar këto rezultate si dhe kanë përcaktuar edhe kombinimin e popullsive ardhëse ndër vite me vendasit, çka përputhet dhe me gjetjet arkeologjike ku jo rastësisht vendbanimi i Linit është 6-8 mijë vjeçar. Kështu, sa më shumë flet inteligjenca artificiale nëpërmjet shkencëtarëve, aq më pak dëgjoen artificat inteligjente të amatorëve.



- Këto ritme të zhvillimit të teknologjive e rrisin sfidën për ne, aq më shumë për të gjithë ju që punoni në fushën ku ritmet janë të paimagjinueshme. 50 vjet më parë, vetëm për të rreshtuar 100 fjalë, a më shumë, sipas alfabetit, duhej puna e një makine llogaritëse që zinte një dhomë, me minuta të tëra.

- Sot, Chgpt e sisteme të ngjashme japin përgjigje për çështje të ndryshme më me logjikë e më të sistemuara se çdo specialist i fushës a çdo punonjës me përvojë, duke optimizuar e sistemuar informacionin në tërësi, në morinë e miliona të dhënave?!, për disa sekonda.

- Kaq larg ka vajtur teknologjia sa që njerëzit po tremben se mos po kalon njeriun. Në fakt, ajo tejkalon mendjen e inteligjencën mesatare, pasi vepron siç e kanë mësuar më të talentuarit e jep të sintetizuara zgjidhjet e mendimet e më të mirëve.

Shpreh edhe një herë vlerësimin dhe përgëzime për organizimin e organizatorët, për dimensionin e këtij aktiviteti, për pjesëmarrjen tuaj, me bindjen se ky event do të kontribuojë për gjithë sa thamë.

Suksese!"

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

## U zhvillua konferenca “Bektashizmi shqiptar në Luftën e Dytë Botërore”



Me rastin e 80-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, më 19 nëntor 2024, Kryegjyshata Botërore Bektashiane, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, zhvilluan konferencën “Bektashizmi shqiptar në Luftën e Dytë Botërore”.

Kryegjyshi Botëror, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, përshëndeti dhe falënderoi për organizmin e kësaj konference Kryetarin e Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushin, dhe kryesinë e kësaj akademie, kërkuesit shkencorë dhe organizatorët.

Në ligjëratën e tij ai foli për kontributin e klerit bektashian në gjithë vijën e historisë së njerëzimit dhe u ndal në kontributet e bektashinjve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në njërën nga figurat më të spikatura, klerikun atdhetar, shenjtin Dede Ahmet Myftari. Ai tha se kontributi i tij i çmuar është pasqyruar në disa botime, të cilat gjenden edhe në Bibliotekën e Kryegjyshit Botërore Bektashiane, dhe theksoi se Dede Ahmetin do ta kujtojmë përgjithmonë me nderim jo vetëm ceremonial apo emocional, por edhe si klerik, atdhetar e filozof të shquar.

Më pas, konferencën e përshëndeti Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi. Ai theksoi se pjesëmarrja e bektashinjve në Luftën e Dytë Botërore është një vlerë e shtuar në historinë e luftës së popullit shqiptar kundër fashizmit.

Akad. Hamit Kaba mbajti kumtesën “Baba Faja dhe bektashinjtë shqiptarë në burimet britanike e amerikane”. Ai tha se klerikët shqiptarë janë treguar luajalë ndaj politikës, patriotë dhe mbështetës të pavarësisë së vendit, pavarësisht nga pozicioni i tyre hierarkik dhe qendrave botërore fetare nga të cilat vareshin.





Akad. Kaba bëri një profil të Baba Faja Martaneshit, duke iu referuar librave dhe shkrimeve historike të autorëve të huaj dhe shqiptarë. Ai theksoi mes të tjerash se: “Baba Faja nuk ishte një element i veçuar, por ishte një përfaqësues i klerikëve bektashinj që kishin përqafuar luftën e popullit shqiptar, nga të cilët 70 dëshmorë vijnë nga nivelet drejtuese të urdhrit bektashi. Ata dhanë një ndihmesë të vyer dhe u përfshinë masivisht në Luftën Nacionalçlirimtare.”



Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi vlerësoi Luftën Nacionalçlirimtare që e renditi Shqipërisë përkrah fituesve të Luftës së Dytë Botërore dhe që i ktheu Shqipërisë lirinë dhe pavarësinë. Ai vuri në dukje vlerat politike, ekonomike, shoqërore dhe kombëtare të Luftës Nacionalçlirimtare, ku edhe dëshmorët e saj duhen kujtuar dhe nderuar.

---

Nuri Çuni dhe Naim Deraj paraqitën një kumtesë për Teqenë e Rabijes, të cilën e vlerësoi si vatër për çlirimin kombëtar. Kjo teqe vuri në dispozicion pasurinë e siguruar me punën dhe mbështetjen e komunitetit bektashian të atyre trevave. Ai vuri në dukje se gjatë Luftës II Botërore në Teqenë e Rabijes, baba Abaz Sherif Memushaj, dervish Bajram Lamaj, dervish Cane, dervish Feimi, dervish Rustemi u vranë barbarisht bashkë me 28 myhibë dhe besimtarë nga fashistët italianë më 23 korrik të vitit 1943 dhe mbetën në historinë e sakrificave sublime që kanë bërë bektashinjtë në luftërat për liri të kombit shqiptar.

Prof. dr. Bektash Mema solli në vëmendjen e të pranishmëve figurat e shquara të klerikëve bektashinj të Gjirokastrës, ndërsa prof. asoc. dr. Bernard Zotaj foli për figurën e klerikëve bektashinj Sali Njazi Dede, Baba Feim Vrëpcka, etj.

Pas kumtesave u bënë pyetje dhe diskutime.

Në përfundim, akad. Hamit Kaba tha se kjo veprimtari shënon një nga hallkat e rëndësishme të konferencave për 80-vjetorin e Çlirimit në Shqipëri. Në konferencat e tjera do të zërë vend edhe kontributi i masave dhe njerëzve të thjeshtë.

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**

## Bujqësia e zgjuar në Shqipëri, arritje dhe sfida për të ardhmen



Sot më 20 nëntor 2024 u zhvillua workshop-i “Bujqësia e zgjuar në Shqipëri, arritje dhe sfida për të ardhmen”.

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil S. Tole mbajti fjalën përshëndetëse në emër të Kryesisë së kësaj akademie,

“Në emër të Kryesisë së ASHSH, përshëndes organizatorët e forumit “Bujqësia e zgjuar në Shqipëri, arritje dhe sfida për të ardhmen”, në mënyrë të veçantë akad. Fatbardh Sallakun dhe prof. dr. Vjollca Ibron, si dhe bashkëpunëtorët e tjerë, të cilët bashkuan studiuesit dhe specialistët më në zë të tokës dhe të teknologjisë bujqësore e bizneseve private që veprojnë në fushën e IT, e cila po gjen aplikim çdo ditë e më shumë në Shqipëri.

Akademia e Shkencave është në vijimësi e angazhuar për të organizuar së bashku dhe promovuar aktivitete të tilla me shumë vlerë, që lidhen me sektorin me të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare që është bujqësia, e cila sot përfaqësohet nga mbi 350 000 fermerë, duke kontribuar me rreth 20% në GDP e vendit.

Me kënaqësi pohojmë bashkëpunimin e Akademisë së Shkencave me Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të misionit për t'i shërbyer sektorit bujqësor dhe rural në vend, duke kontribuar në ekonominë e vendit dhe mbështetur kështu gjithë konsumatorët shqiptarë.

Nuk është e tepërt të pohojmë se “bujqësia e zgjuar” është një nga sektorët më të rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve të qëndrueshmërisë globale që lidhen me sigurinë ushqimore të popullatës. Kjo tendencë u përshpejtua pas rritjes së shpejtë të kërkesave për

---

ushqim nga ana e popullsisë, në kushtet kur ka ndryshime të ndjeshme të kushteve klimaterike shoqëruar me kufizimin e burimeve natyrore, veçanërisht të ujit dhe të sipërfaqeve të tokës.

Të dhënat e fundit tregojnë se rreth 60-70% e tokave në Bashkimin Europian janë të pashëndetshme, ndërkohë që situata në Shqipëri ende është në proces vlerësimi dhe monitorimi.

Që nga fillimi i saj në vitet 1990, kur u parapa përdorimi i GPS-së dhe sistemeve gjeohapësinore për të monitoruar dhe optimizuar përdorimin e burimeve bujqësore, dhe më pas në vitet 2000 me përfshirjen e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në bujqësi për monitorimin e të dhënave në kohë reale, Shqipëria ka bërë hapa të mëdhenj.

Pas këtij momenti, është bërë futja e dronëve për monitorimin e parcelave dhe rritja e aksesit në matjen e parametrave të tokës dhe të klimës.

Pas viteve 2010, zhvillimet teknologjike kanë kulmuar me përdorimin e Internet of Things (IoT) dhe inteligjencës artificiale (AI) në bujqësi, të cilat, në bashkëpunim me politikat mbështetëse, kanë transformuar mënyrën e prodhimit të produkteve ushqimore në shumë vende.

Tashmë njihen botërisht arritje të tilla si “serat inteligjente”, përvojë holandeze kjo, apo përvoja gjermane në zhvillimin e aplikacioneve që ndihmojnë fermerët në parashikimin e motit dhe analizat e tokës, etj.

Në vitin 2021, Komisioni Europian miratoi misionin mbi Marrëveshjen e Tokës për Europën, për periudhën 2021-2027, me qëllim kryesor rritjen e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës, ruajtjen e shëndetit dhe cilësinë e saj, ndërkohë që mbështet rritjen e kulturave të ndryshme bujqësore dhe rendimentin e tyre pa dëmtuar mjedisin.

Prandaj jemi sot këtu, që Shqipëria, e cila ka filluar të adoptojë pjesërisht elemente të “bujqësisë së zgjuar”, të avancojë më tej në këtë drejtim edhe pse është ende në faza të hershme krahasuar me vendet e zhvilluara. Nga ana tjetër, kjo mund të shndërrohet në avantazh pasi e bën këtë fushë një mundësi të madhe për inovacion dhe përmirësim. Përvojat që vijnë nga vende të ngjashme me ne kanë provuar se kombinimi i teknologjisë me traditën mundëson avantazhe që nuk duhen humbur. Vende të ngjashme janë shndërruar në liderë rajonalë për produktet e qëndrueshme dhe cilësore bujqësore falë kësaj qasjeje inovatore.

Tematika e këtij aktiviteti duke trajtuar çështjet e bujqësisë së zgjuar në Shqipëri, e konsideron tokën si aset dhe si një laborator të gjallë, nisur nga fakti se toka është një burim i brishtë që duhet të menaxhohet dhe ruhet me kujdes për brezat e ardhshëm.

Laboratorët e gjallë janë vende për demonstrimin e zgjidhjeve, trajnimit dhe komunikimit. Janë këto laboratorë të gjalla të cilët do të ekspozojnë praktika që duhen ndjekur sa i përket sigurimit të prodhimit të qëndrueshëm, të ushqimeve të shëndetshme si dhe të shërbimeve të ekosistemit që lidhin komunitetet rurale dhe urbane dhe që ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme për zhvillimin e bujqësisë dhe mbrojtjes mjedisore.

Janë pikërisht këto hapësira që i lejojnë pronarët dhe menaxherët e tokës të angazhohen maksimalisht, bashkë me grupet e interesit nga sektorë të ndryshme, apo autoritetet publike dhe qytetarët, duke përfshirë këtu edhe konsumatorët, që të punojnë së bashku me kërkuesit nga disiplina të ndryshme, për të gjetur dhe zhvilluar zgjidhje dhe për të identifikuar hapësira në shëndetin e tokave dhe menaxhimin e kulturave të ndryshme.

---

Duhet të ndjehemi të inkurajuar edhe nga aprovimi i ligjit të ri për shkencën, i cili ka në thelb të tij citoj: “sigurimin e produkteve të kërkimit shkencor që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, si dhe konsolidimin e identitetit kombëtar; “fuqizimin e aftësive për të menaxhuar progresin teknologjik dhe të përgjithshëm shoqëror, si burimi kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm”, dhe “përvetësimin e aftësive dhe njohurive të reja, transferimin e tyre për përfitimin e përgjithshëm publik, me synim rritjen e mirëqenies sociale” etj.

Të gjitha këto janë një garanci më shumë që më vendin tonë të rritet përmirësimi i aksesit në teknologji përmes subvencione të dedikuara ose kredive me interesa të ulëta për investime në teknologji, të rritet mbështetje për startup-et bujqësore që zhvillojnë teknologji të përshtatshme për kontekstin shqiptar, duke e kombinuar këtë me krijimin e programeve arsimore dhe trajnimeve për fermerët për të përdorur teknologji të avancuar.

Nga ana tjetër, mbetet gjithmonë e këshillueshme që të gjitha nismat të reflektojnë në një bashkëpunimin rajonal më të plotë, si përmes projekteve ndërkuftare me Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut për ndarjen e përvojave dhe burimeve.

Prandaj e mbështesim këtë takim, në mënyrë që ndjekja e përvojave evropiane mbetet një faktor thelbësor për të tejkaluar sfidat dhe për të përfituar nga potenciali i plotë i sektorit duke përdorur elementet e “bujqësisë së zgjuar”.

Partneriteti i ngushtë i ASHSH, i Komisionit të Përhershëm të Bujqësisë pranë saj me UBT-në, do të mundësojë këshillime të vazhdueshme të ekspertëve në implementimin e praktikave më të mira të bujqësisë së zgjuar, si dhe duke orientuar të rinjtë drejt studimeve në fusha të tilla prioritare si bujqësia, inxhinieria e pyjeve, etj.

Jemi shpresëplotë, se gjetjet dhe përfundimet e këtij workshop-i do t’u shërbejnë institucioneve tona për t’i përfshirë këto çështje në agjendat prioritare dhe do të ndikojnë në gjetjen e rrugëve të tjera të bashkëpunimit në të ardhmen.

Punime të mbara dhe ju faleminderit për vëmendjen!”

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**



## Konferencë shkencore ndërkombëtare me rastin e 75-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Republikës Popullore të Kinës dhe Republikës së Shqipërisë



Në 11 nëntor 2024, Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri zhvilluan një konferencë shkencore ndërkombëtare.

Konferenca u mbajt me rastin e 75-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Republikës Popullore të Kinës dhe Republikës së Shqipërisë, me pjesëmarrjen e studiuesve të akademive të të dyja vendeve.

Seanca plenare u çel nga akad. asoc. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, i cili përshëndeti pjesëmarrësit dhe i dha fjalën akad. Skënder Gjinushit, Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akad. Gjinushi vlerësoi kontributet në trashëgiminë tonë të përbashkët jo vetëm në shkencat shoqërore, por edhe me ekspeditat arkeologjike, shkëmbimet arkivistike dhe formimin e ekspertëve për disiplinat e identitetit, si dhe në projektimin e ndërtimin e veprave të mëdha hidroenergjetike e industriale në vend. Ai vuri në dukje, mes të tjerash, kujdesin e Akademisë së Shkencave Shoqërore të Kinës në fillimin e viteve 1970 për "shërimin" dhe shpëtimin e dy dorëshkrimeve më të hershme të Shqipërisë dhe nga më të hershmit në shkallë botërore, të njohur si Kodikët e Beratit, shpallur prej dy dekadash nga UNESCO si pjesë e regjistrit të vlerave më të rëndësishme të Njerëzimit, në programin "Memoire du Monde".

Në fund të fjalës së tij, akad. Gjinushi foli për mundësitë e evokimit, rizgjimit e ringritjes së bashkëpunimit të drejtpërdrejtë të Akademisë sonë të Shkencave me qendrat më të rëndësishme kërkimore-shkencore kineze, duke nënshkruar marrëveshje e protokolle

ndërakademike e ndërinstitutionale që krijojnë perspektiva të sigurta dhe korniza ligjore të qarta.

Më pas konferencën e përshëndeti znj. Pang Chunxue, ambasadorja e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri. Ajo foli për misionin e promovimit të zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve mes dy vendeve.



Në fjalën e saj, ambasadorja Chunxue theksoi: “Kina mbron barazinë midis vendeve të mëdha dhe të vogla, respekton rrugën e zhvillimit të zgjedhur në mënyrë të pavarur nga populli shqiptar, mbështet përpjekjet e palës shqiptare për t’u integruar në Europë dhe është e kënaqur që sheh përfundimin e hershëm të negociatave për anëtarësimin në BE.”

Konferenca u përshëndet dhe nga zëvendës- ministrja për Europën dhe Punët e Jashtme znj. Megi Fino, e cila shprehu kënaqësinë e pjesëmarrjes në këtë manifestim të 75-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike. Ajo tha, mes të tjerash, se miqësia mes Kinës dhe Shqipërisë ka në themelet e saj jo vetëm marrëdhëniet diplomatike, por edhe vlerat në fushën e arsimit, sportit, kulturës dhe shkencës. Znj. Fino kujtoi kontributet e Republikës së Kinës dhe popullit kinez për vendin tonë dhe vuri në dukje punën që po bëhet për forcimin e bashkëpunimeve dypalëshe për zhvillimin ekonomik dhe në drejtime të tjera, si në teknologji, në turizëm edhe më gjerë. Në fund, znj. Fino falënderoi Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademinë e Shkencave të Shangait që bënë të mundur organizmin e kësaj veprimtarie.

Përshëndetën konferencën në emër të grupit të studiuesve pjesëmarrës nga Kina prof. Wang Jian nga Akademia e Shkencave Shoqërore e Shangait (SASS) dhe drejtori i Institutit për Marrëdhënie Ndërkombëtare z. Spartak Nano, president i Shoqatës Shqipëri-Kinë.

Seanca e parë e konferencës u drejtua nga prof. dr. Hamit Kaba dhe prof. dr. Wang Jian.



Punimet u hapën me kumtesën e prezantuar nga prof.dr. Ksenofon Krisafi, anëtar i komisionit të përhershëm të historisë pranë Akademisë së Shkencave dhe dr. Kejsi Rizon (UET), me titull “Protagonizmi diplomatik i Shqipërisë për rivendosjen e të drejtave të ligjshme të RP të Kinës në OKB”.

Prof. Dai Yichen, zëvendësdrejtoresh e Institutit për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Shangait - SASS, paraqiti punimin me titull “Marrëdhëniet Kinë-Shqipëri në kuadër të bashkëpunimit Kinë-CEEC”.

Prof. asoc. dr. Gjon Boriçi, nga Instituti i Historisë, pranë ASHSH trajtoi temën “Vlerësimet e diplomacisë britanike mbi marrëdhënien e ngushtë shqiptaro-kineze pas daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës”.

Prof. dr. Ma Sai nga Universiteti i Gjuhëve të Huaja i Pekinit prezantoi punimin me titull “Pranimi i letërsisë bashkëkohore shqiptare në Kinë”.

Sesioni i parë u mbyll me punimin e prezantuar nga dr. Gëzim Podgorica, nënkryetar i Këshillit Drejtues të RTSH, me titull “Kina, një gravitet i epokës së re”.

Seanca e dytë e konferencës u drejtua nga prof. dr. Ma Sai dhe prof. dr. Ksenofon Kristafi.



---

Punimet vijuan me kumtesën e prezantuar nga prof. dr. Hamit Kaba, drejtor i Institutit të Historisë (ASHSH), i cili paraqiti punimin me titull “Dilemat e Perëndimit për ndarjen e Shqipërisë nga Kina”.

Prof. Li Min nga Instituti për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Shangait - SASS referoi temën me titull “Për një të ardhme të gjelbër: zhvillimi i energjisë së rinovueshme në Kinë dhe bashkëpunimi me Shqipërinë”.

Më tej, dr. Iljaz Spahiu, nga Shoqata Kulturore "Alb-China", prezantoi punimin me titull “Disa nisma shkencore-albanologjike në Kinë”.

Seanca e dytë u përmbyll me referimin e prof. Zheng Baoguo, drejtor i Institutit "Confucius" pranë Universitetit të Tiranës, me titull “E kaluara dhe e tashmja e mësimdhënies së gjuhës kineze në Shqipëri”.

Në fund të veprimtarisë prof. dr. Kristafi bëri konkluzionet e konferencës, të cilën e cilësoi si një ngjarje të rëndësishme që e spikat 75-vjetorin e marrëdhënieve diplomatike mes Republikës Popullore të Kinës dhe Shqipërisë me një histori pozitive. Optimizmi i shprehur për këto marrëdhënie ka karakter shkencor, tha prof. dr. Kristafi, sepse karakteristikat e këtyre marrëdhënieve janë të studiuara nga akademikë e studiues të njohur të Kinës dhe të Shqipërisë.

Përgjatë kësaj konference u veçuan momentet më të rëndësishme të historisë 75-vjeçare të marrëdhënieve tona ndërshtetërore, duke filluar prej nismave diplomatike shqiptare për rinjohjen e Kinës në organizatat ndërkombëtare, para së gjithash në OKB; deri te bashkëpunimi ekonomik dhe shkëmbimet shkencore, teknologjike e kulturore, të cilat patën shtrirjen e tyre në të gjitha fushat në vitet 1960-1970.

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**



## U zhvillua seminari “Cilësia e ajrit dhe frymëmarrja e shëndetshme tek fëmijët (çerdhe-kopshte-shkolla) dhe ventilimi smart i tyre”

Sot më 18 nëntor 2024, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike dhe Komisioni i inxhinierisë pranë kësaj akademie në bashkëpunim dhe Institutin e Shëndetit Publik zhvilluan seminarin “Cilësia e ajrit dhe frymëmarrja e shëndetshme tek fëmijët (çerdhe-kopshte-shkolla) dhe ventilimi smart i tyre”.

Seminari u mbajt në Hotel Tirana International me praninë fizike dhe online të inxhinierëve dhe kërkuesve të fushës, përfaqësuesve të institucioneve shtetërore nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkia e Tiranës, Instituti i Shëndetit Publik, pedagogë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe studio profesionale të arkitekturës dhe agjencive politikëbërëse dhe zbatuese të lidhura ngushtë me çështjen.



Veprimtarinë e çeli akad. Jorgo Kaçani, i cili përshëndeti të pranishmit. Ai vuri në dukje se ky seminar është organizuar me synimin që të japë kontribut për zbatimin e normave dhe standardeve të miratuara që duhen respektuar, dhe jo vetëm të respektohen, por edhe të jenë të detyrueshme e jo vullnetare për t'u respektuar e zbatuar, me synimin për të rritur cilësinë e ajrit dhe teknologjinë e ventilimit në çerdhe-kopshte-shkolla.

Akad. Kaçani falënderoi Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe Kryesinë e kësaj akademie për mbështetjen dhe organizimin e seminarit, si dhe përfaqësuesit nga Ministria e

Arsimit dhe e Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Konferencën e përshëndetën edhe prof. dr. Ramadan Alushaj dhe znj. Majlinda Memetaj (MAS), të cilët e vunë theksin tek rëndësia që ka ky seminar për të përmirësuar në shkolla cilësinë e ajrit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të parametrave të duhura për të ruajtur cilësinë e ajrit tek fëmijët.



Sesioni i parë i këtij seminari u çel me prezantimin e punimit të dr. Ariela Malaj (NJVKSH/DROSHKSH, Tiranë) për çështje të mjedisit në shkolla, kopshte e çerdhe, sipas këndvështrimit të stafit shëndetësor.

Znj. Majlinda Memetaj (MAS) foli për përmirësimin e infrastrukturës dhe mjediseve të shkollës, mbështetur në normat dhe standardet e ndërtesave shkollore për të siguruar arsim cilësor, gjithëpërfshirës, si dhe mirëqenien e shëndetin mendor të nxënësve të arsimit parauniversitar.

Prof. dr. Elida Mataj (ISHP) prezantoi vlerësimet e bëra për ekspozimin ndaj ndotësve të ajrit të brendshëm në shkolla, sipas një ankete pilot të OBSH-së në Shqipëri.

Dr. Irina Branko dhe dr. Ledita Mezini (UPT) prezantuan rezultatet e kërkua për transformimin e cilësisë hapësinore dhe kushteve ambientale përgjatë viteve në shkollat e Tiranës.

Dr. Ramadan Alushaj dhe prof. asoc. dr Flamur Bidaj (UPT) trajtuan cilësinë e ajrit dhe frymëmarrjen e shëndetshme tek fëmijët në çerdhe, kopshte e shkolla.

Sesioni i dytë u zhvillua me drejtimin e akad. Jorgaq Kaçani, prof. dr. Ramadan Alushaj, prof.dr. Elida Mataj me diskutime, pyetje e përgjigje.

Si përfundim, seminari përgjatë dy sesioneve shkencore trajtoi çështje të përmirësimit të infrastrukturës dhe mjediseve të shkollës, mbështetur në normat dhe standardet e

ndërtesave shkollore, për të siguruar arsim cilësor, gjithëpërfshirës, mirëqenien dhe shëndetin mendor të nxënësve të arsimit parauniversitar.



Studimet kanë zbuluar se rreth 98% e shkollave janë në zona që tejkalojnë kufijtë e ndotjes së OBSH-së për PM 2.5, madhësia më e dëmshme e grimcave, krahasuar me 24% jashtë qyteteve .

UNICEF për qytetet europiane vlerësoi në vitin 2018 se një në tre fëmijë po rritej në zona me nivele të larta të grimcave, në total 4.5 milionë fëmijë në qyteza dhe qytete. Fëmijët e vegjël në klasë thithin rreth 100-200 mg/ditë pluhur, rreth 2-4 herë më shumë se sasia e të rriturve.

Hulumtimet gjatë dekadave kanë treguar se cilësia e dobët e ajrit të brendshëm në shkolla ka një sërë efektsh në shëndetin e fëmijëve, në aftësinë për të mësuar dhe performancën akademike. Efektet e gjera dhe afatgjata shëndetësore të ndotjes janë të njohura dhe përfshijnë sëmundjet e mushkërive, sëmundjet kardiovaskulare, infarktën e miokardit, dështimin e zemrës, çrregullimet neurologjike, diabetin dhe kancerin.

Faktorë të shumtë e bëjnë menaxhimin e cilësisë së ajrit në shkolla, një prioritet të lartë për të garantuar shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve, stafit dhe performancën arsimore të tyre.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)



---

## Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua më datë 16 tetor 2024 Workshopi “Tranzicioni Energjitik dhe Shqipëria”

Veprimtaria u organizua nga Komisioni Inxhinierisë, Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike i Akademisë së Shkencave, në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të UPT.

Në takim ishin të pranishëm Kryetari i Komisionit Inxhinierisë, akademike, drejtues dhe specialistë nga ERE - Enti Rregullator i Energjisë, OST - Operatori i Sistemit të Transmetimit, OSSH-Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, AREA - Shoqata Shqiptare e Energjive të Rinovueshme, pedagogë dhe doktorantë nga Fakulteti Inxhinierisë Elektrike-UPT, Fakulteti Inxhinierisë Mekanike-UPT, pedagogë nga Universiteti i Prishtinës - Kosovë, doktorantë nga Fakulteti Ekonomisë-UT, etj.

Akad. Jorgaq Kaçani, kryetar i Komisionit Inxhinierisë, përshëndeti të pranishmit dhe vuri në dukje se çështja e tranzicionit energjitik do të siguronte përfitime të rëndësishme për mjedisin, ekonominë dhe cilësinë e jetës për njerëzit. Rritja e shpejtë e burimeve të rinovueshme është vetëm hapi i parë drejt përshpejtimit të tranzicionit dhe zhvillimi këtij workshopi-i synon të ndikojë në këtë drejtim.



Akad. Rajmonda Buhaljoti prezantoi sfidat drejt një tranzicioni energjie që bazohet në burimet e rinovueshme që është i rëndësishëm sepse sjell përfitime që shkojnë përtej zgjidhjes së krizës klimatike. Urgjenca e përshpejtimit të tranzicionit lidhet si me natyrën hidroenergjiqe që është gjithnjë e më e prekshme ndaj ndryshimeve në hidrologji dhe politikat e veprimit të Bashkimit Evropian për klimën si një shtytës shtesë drejt tranzicionit të energjisë për kalimin e shpejtë drejt sistemeve të sigurt, të pastra dhe të integruara të energjisë. Tranzicioni energjitik mbështet zhvillimin e qëndrueshëm, përmirëson shëndetin duke reduktuar ndotjen, krijoni vende të reja pune dhe rritje ekonomike. Më këtë takim do të hapet rruga për njohjen



---

ballafaqimin e këtyre problemeve ndërmjet aktorëve që veprojnë nga operatorët e kompanive energjitike e deri tek kërkuesit shkencor.

Në kumtesat e tyre Msc.Ing. Elio Voshtina nga Operatori i Sistemit të Transmetimit parashtrori sfidat e sistemit shqiptar të transmetimit në kushtet e tregjeve të hapura të energjisë dhe integritet të burimeve të rinovueshme në rajon, Prof.ass.Dr. Arben Gjukaj nga Universiteti i Prishtinës diskutoi mbi përballimin e sfidave të tranzicionit energjetik në Kosovë përmes burimeve të rinovueshme, Z. Deni Rushaj nga Enti Regullator i Energjisë, diskutoi mbi politikën mbështetëse për Tranzicionin Energjetik dhe Legjislacionin, Znj. Anita Shushku nga Shoqata Shqiptare e Energjive të Rinovueshme trajtoi Sigurinë juridike të investimeve në energjitë të rinovueshme në Shqipëri-pritshmëria e investitorëve për një tranzicion të qëndrueshëm, ndërsa Msc.Ing Xheni Kazaferi nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, diskutoi në lidhje me Situatën aktuale të rrjetit shpërndarës dhe strategjia në lidhje me tranzicionin energjetik, Prof.as. Flamur Bidaj prezantoi analiza e ndikimit të pompave të nxehtësisë në konsumin e energjisë elektrike në sektorin e banesave ndërsa Msc.Ing Andi Hida nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike diskutoi për potencialin e qyteteve inteligjente dhe i komuniteteve të energjisë së rinovueshme.

Përgjatë diskutimeve u theksua nevoja për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse në fushën e energjisë. Integrimi i burimeve të rinovueshme me ndërprerje është një sfidë, gjë që kërkon që do të duhet të investohet në rrjetet elektrike, të forcohet ndërlidhja rajonale, të sigurohet lidhja e tregjeve të energjisë elektrike - si brenda rajonit ashtu edhe me vendet fqinje - të tërheqin investime në zgjidhje fleksibiliteti për të menaxhuar balancimin dhe të vendosin korniza për të siguruar investime në rezerva. Njëkohësisht duhen menaxhuar ndryshimet e thella socio-ekonomike që do të sjellë tranzicioni i energjisë - veçanërisht efektet në komunitetet që varen nga qymyri për jetesën e tyre.

## U zhvillua konferenca shkencore me temë: "Ripërtëritja e historisë"

Më 21 nëntor 2024 u zhvillua konferenca shkencore me temën "Ripërtëritja e Historisë nga Shtabi i përgjithshëm i FA, Akademia e Forcave të Armatosura në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Kjo veprimtari zhvillohet në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, që është miratuar si vit jubilar mbarëkombëtar nga Këshilli i Ministrave.

Hapja e konferencës u bë nga gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, komandanti i Akademisë FA, i cili përshëndeti pjesëmarrësit dhe organizatorët e konferencës. Ai foli për kontributin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare në çlirimin e vendit.

Më pas mbajti një fjalë përshëndetëse edhe Gjeneral Major Arben Kingji, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-it. Ai falënderoi Kryesinë e Akademisë dhe organizatorët e konferencës për kontributin që kanë dhënë për historinë ushtarake dhe atë kombëtare.

Sesioni i parë u moderua nga akad. Marenglen Verli, prof. dr. Hamit Kaba, prof. dr. Ethem Çeku dhe prof. Asoc. dr. Etleva Smaçi.



Ky sesion nisi me ligjëratën e prof. dr. Çekut për ndikimin e çlirimit në identitetin kombëtar, të argumentuar me analiza shkencore.

Prof. asoc. dr. Etleva Smaçi mbajti një ligjëratë për historikun e Brigadave Antifashiste përmes rishikimit të fakteve, ngjarjeve, personazheve si kontribut për Historinë Ushtarake dhe atë Kombëtare.

Prof. dr. Hamit Kaba në kumtesën e tij prezantoi kërkimet më të fundit për përplasjet e brendshme dhe qëndrimet e aleatëve britanikë dhe amerikanë.



Akad. Marenglen Verli paraqiti kërkimet për revoltën e Drenicës, si pasojë e trajtimit shovinist të shqiptarëve nga Partia Komuniste Jugosllave.

Prof. asoc. dr. Mrika Limani Myrtaj në kumtesën e saj bëri një rishikim të ligjërimeve mbi fituesit e LDB-së dhe ngritjes së ekstremit të djathtë, 80 vjet pas çlirimit, Rasti i Kosovës.

Prof. dr. Sabit Syla foli për operacionin Kosova 1944, duke bërë një analizë krahasuese ndërmjet rrymave politike dhe formacioneve ushtarake.

Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi foli për parimet e Kartës së Atlantikut dhe kuvendet shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Prof. Asoc. Dr. Teki Kurti mbajti një kumtesë për rezistencën në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, sipas këndvështrimit të shtypit anglo-amerikan.



---

Prof. asoc. dr. Alban Dobruna foli për konferencën e Bujanit si orientim i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Kosovë.

Sesionin e dytë e moderuan prof. dr. Sabit Syla, prof. asoc. dr. Teki Kurti, prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi, dr. Blerina Kuqi.

Në këtë sesion mbajtën ligjërata dr. Blerina Kuqi, prof. asoc. dr. Edmond Braneshi, prof. asoc. Dr. Haxhi Ademi, dr. Haxhi Ademi, Orges Xhangolli, dr. Lorenc Agalliu, Sali Onuzi, Kujtim Zeka, dr. Entela Abdul dhe kolonel Dilaver Hoxha.

Gjatë zhvillimi të këtij sesiioni iu kushtua vëmendje rivendosjes së kujtesës historike, duk iu dhënë rëndësi hulumtimeve shkencore për 80- vjetorin, intensifikimit të lëvizjes antifashiste, brigadave sulmuese në Shqipëri në Luftën II Botërore, misionet aleate në Shqipëri gjatë kësaj lufte, kontributit të partizanëve italianë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, si dhe kontributit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare për çlirimin e vendit, etj.

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**



## U zhvillua forumi akademik “Mbi vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore”

Më 21 nëntor 2024 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbajt forumi akademik “Mbi Vlerësimin e Rrezikut dhe Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore.

Veprimtaria u çel nga akad. asoc. Rrapo Ormeni, drejtues i Njesisë Kërkimore të Gjeoshkencave dhe Gjeoinxhinierive me praninë e Kryetarit të ASHSH-së, akad. Skënder Gjinushi.



Akad. asoc. Ormeni shprehu mirënjohjen dhe falënderimet për bashkëpunimin e grupit kërkimor shkencor “Inxhinieria e strukturave dhe tërmeteve” brenda NJKGJGJ të ASHSH-së dhe për drejtuesin e grupit prof. Huseyin Biglin, si dhe për bashkëpunëtorët e ngushtë të departamentit të inxhinierisë së ndërtimit të Universitetit Epoka dhe “Komisionit të historisë dhe arkeologjisë” pranë Akademisë së Shkencave. Ai vlerësoi edhe bashkëpunimet e tjera me institucionet dhe njësitë kërkimore shkencore të kësaj fushe në vendin tonë, në Kosovë dhe Maqedoni.

Akad. asoc. Ormeni tha se realizimi i studimeve të tilla shkencore specifike dhe në nivel të lartë u arrit në saj të vizionit dhe hapjes së madhe që Asambleja, Kryesia dhe Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi, duke i dhënë kërkimit shkencor hapësirë për bashkëpunime të gjera me institutet kërkimore dhe njësitë kërkimore në Shqipëri, Kosovë,

Maqedoni dhe më gjerë.



Akad. Ormëni tha se trashëgimia kulturore është një nga aspektet më të rëndësishme në shoqëritë moderne, pasi bart vlera të shumta sociale dhe historike. Iniciativat për të menaxhuar rrezikshmërinë ndaj fatkeqësive është një hap i rëndësishëm për të siguruar që këto thesare të vazhdojnë të mbijetojnë dhe të ruhen për brezat e ardhshëm.

Akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, përshëndeti në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave ai theksoi se është detyra jonë e përbashkët që t'i restaurojmë, t'i ruajmë dhe t'i forcojmë këto pasuri të paçmueshme, për t'ua lënë trashëgim brezave të ardhshëm.



---

Me tej përshëndetën rektori i Universitetit Epoka prof. Ahmet Oztas, i cili theksoi bashkëpunimin e ngushtë me Akademinë e Shkencave për rritjen e kërkimit shkencor.

Përshëndetën, gjithashtu, prof. Kemal Edip nga IZIIS, Maqedonia e Veriut dhe Isa Boletini e prof. Festim Kollevci nga Universiteti i Mitrovicës.



Më pas u bënë prezantimet e punimeve shkencore, gjatë të cilave u zhvilluan diskutime mbi metodologjitë novatore, si përdorimi i radarëve me depërtim në tokë për analiza jo-invazive, të cilat na pajisin me të dhëna kritike për menaxhimin e siteve të trashëgimisë.

U paraqit korniza gjithëpërfshirëse për vlerësimin dhe menaxhimin e praktikave specifike për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, me raste studimi të detajuara për objekte të trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe Kosovë.

Theksi u vu mbi problemet e menaxhimit të keq dhe praktikave të restaurimit të pakualifikuar, duke bërë thirrje për reforma që të mbrohet trashëgimia jonë në mënyrë efektive, duke theksuar nevojën për përkushtim ndaj projekteve origjinale.

Studimet u përqendruan edhe mbi cënueshmëritë sizmike të trashëgimisë kulturore në zonat e ndjeshme ndaj tërmeteve.

Pjesëmarrësit në këtë forum e dhanë të qartë mesazhin për t'i çuar përpara njohuritë e fituara në këtë forum shkencor, duke punuar së bashku për të siguruar qëndrueshmërinë e trashëgimisë sonë për brezat e ardhshëm.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)



---

## U zhvillua konferenca e 1-rë kombëtare mbi kancerin e gjirit në Shqipëri. “Kanceri i gjirit, vëmendje jo vetëm në tetor: të dhëna epidemiologjike, klinike dhe eksperiencia e Shqipërisë”



Më datë 26 nëntor 2024, Komisioni i mjekësisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë organizoi konferencën e parë kombëtare mbi kancerin e gjirit në Shqipëri me titullin “Kanceri i gjirit, vëmendje jo vetëm në tetor: të dhëna epidemiologjike, klinike dhe eksperiencia e Shqipërisë”. Konferenca u hap nga akad. Genc Sulçebe, kryetari i Komisionit të mjekësisë, i cili, pasi theksoi rëndësinë dhe domosdoshmërinë për të organizuar një konferencë kombëtare me një paraqitje multidisiplinare të kësaj patologjie, që përfaqëson tumorin më të shpeshtë në seksin femër si në vendin tonë, ashtu edhe në botë, ia kaloi fjalën kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Gjinushit, për të përshëndetur punimet e saj.



Në fjalën e tij, akad. Gjinushi theksoi rëndësinë e punës kërkimore të komisioneve të ngritura pranë Akademisë së Shkencave si rezultat i riorganizimit të saj, veçanërisht



bashkëpunimin e frytshëm të Komisionit të Mjekësisë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Institutin e Shëndetit Publik, Qendrën Spitalore Universitare etj. Ai vlerësoi rëndësinë që ka kjo konferencë për trajtimin sa më shkencor të çështjeve që lidhen me shëndetin.

Konferenca u përshëndet gjithashtu nga zëvendësministrja znj. Mira Rakacolli, e cila theksoi sfidën dhe mekanizmat që ka sistemi shëndetësor në trajtimin e sëmundjeve tumorale, duke shtuar edhe rëndësinë që kanë këto çështje në përfshirjen e politikave shëndetësore të qeverisë shqiptare.



Prof. Alban Ylli nga Instituti i Shëndetit Publik, në kumtesën e tij paraqiti një panoramë të plotë të epidemiologjisë së kancerit të gjirit në vendin tonë. Të dhënat e regjistrit tonë kombëtar janë krahasuar gjithashtu me vlerësimet ndërkombëtare të GLOBOCAN. Incidenca dhe prevalenca e kancerit të gjirit kanë ardhur në rritje gjatë dekadave të fundit, kryesisht për arsye të rritjes së moshës mesatare, urbanizimit dhe ndryshimeve në stilin e jetesës (përfshirë uljen e fertilitetit). Kjo rritje është ndikuar gjithashtu nga rritja e ndërgjegjësimit dhe diagnozës më të hershme të këtij kanceri. Në Shqipëri, kanceri i gjirit përbën më shumë se 11% të të gjitha rasteve të reja me kancer çdo vit, dhe rreth 30% e grave që jetojnë në popullatë me një neoplazi malinje, kanë kancer gjiri. Në vitin 2023 u diagnostikuan 744 femra me kancer gjiri ose 61.4 për 100,000 femra (u diagnostikuan gjithashtu edhe 15 raste kanceri gjiri te meshkujt). Prej vitit 2015 vërehet një rritje rreth 14% e incidencës. Risku për t'u diagnostikuar me kancer gjiri rritet me moshën deri në 70 vjeç. Risku maksimal është në moshën 50 deri në 70 vjeç. Risku është shumë i ulët, por jo zero, në moshën 20-30 vjeç. Mbijetesa nga kanceri i gjirit në Shqipëri ishte 73% në 2022 dhe 72% në vitin 2023, dhe ka luhatur pranë vlerës 70% prej vitit 2015.



Prof. Helidon Nina, në kumtesën e tij, theksoi se është thelbësore të realizohet një diagnozë e saktë nga stafi i duhur multidisiplinar mjekësor. Për diagnozën përdoren palpimi, ekografia, mamografia, biopsia kore, CT, MRI, etj. Rëndësia e stafit multidisiplinar nuk është vetëm vënia në statistika e rasteve që janë nën trajtim specifik, por analizimi i çdo pacienti në çdo element që përbën patologjinë e tij, që nga prezantimi i parë në spital e sigurimi dhe respektimi i të gjitha udhëzimeve aktuale në çdo trajtim specifik. Gjithashtu, trajtimi kirurgjik i gjirit ka evoluar ndjeshëm, veçanërisht në 30 vitet e fundit; kjo është edhe pasojë e përmirësimit të teknologjisë mjekësore. Trajtimi i kancerit të gjirit, theksoi prof. Nina, po evoluon vazhdimisht. Stafi i MDT-së është vendimtar jo vetëm për trajtimin e duhur të pacientëve, por edhe për përditësimin e udhëzimeve dhe imponimin e strukturës së duhur vendimmarrëse në shëndetësi.



Dr. Anila Pema, onkologe pranë Shërbimit të Onkologjisë në QSUNT, theksoi se nevojitet një program për trajtimin e kancerit të gjirit në vendet me burime të ulëta, që të

adresoje nevojat e parandalimit, diagnostikimit, trajtimit dhe kujdesit paliativ te pacienteve me kancer. Kjo kthehet ne nje detyre te veshtire dhe shpesh rezulton ne humbjen e vullnetit politik te nevojshem per te siguruar qendrueshmeri. Barrierat kryesore per zhvillimin bashkekohor te programit te kujdesit ndaj kancerit jane: 1. Financimi qeveritar, hartimi i politikave; 2. Mungesa e kapaciteteve njerzore; 3. Infrastruktura shendetesore; 4. Diagnoza sa me e shpejte; 5. Disponueshmëria e te gjitha kapaciteteve trajtuese si rrezatimi, kimioterapia, kirurgjia, kujdesi paliativ.



Dr. Fationa Kraja, specialiste e radioterapisë pranë QSUT, ngriti problemin se avancimet në fushën e radioterapisë kërkojnë mundësimin e një trajtimi sa më të sigurt për organet përreth tumorit dhe, në të njëjtën kohë, një kohë më të shkurtër trajtimi me doza më të larta në nivel të tumorit. Këto kërkojnë investime të reja dhe përbëjnë sfidën kryesore për radioterapinë në vendin tonë. Sfidat afatshkurtra mbeten implementimi i teknikave të avancuara që sot në Europë janë pjesë e praktikës klinike në radioterapi dhe që përfshijnë trajtime me doza të larta në nivel të tumorit, me dozë fraksioni mbi 5 Gy, si trajtimi stereotaktik, i cili përdoret si për tumoret primare ashtu edhe për lezionët metastatikë.

Dr. Vladimir Titka theksoi se mjekësia nukleare po zë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në diagnozën e kancerit të gjirit. Studime të mëtejshme nevojiten për të përcaktuar përfundimisht rolin e saj diagnostik.

Dr. Alketa Çoku nënvizoi në fjalën e saj se, prioriteti i punës së psikologut është themelor në menaxhimin e stresit dhe traumës, dhe të psikopatologjive të ndryshme, nëpërmjet një pune individuale klinike me pacientin ose në kontekstin e grupit të terapisë monosimptomë. Shpeshherë është e nevojshme një bashkëpunim dhe referim me mjekët specialistë psikiatër.



Dr. Ilir Kurtishi nga Qendra Klinike Universitare Onkologjike në Prishtinë raportoi se në vitin 2019 Kosova regjistroi 338 raste të kancerit të gjirit, me incidencën më të lartë të vërejtur në grupmoshën 60-64 vjeç. Pandemia ndikoi ndjeshëm në raportimin e kancerit, duke rezultuar në një rënie prej 16% të rasteve të reja në vitin 2020. Megjithatë, pas pandemisë, pati një rritje dramatike të diagnostikimeve të reja, duke arritur në 400 raste të reja të kancerit të gjirit dhe 2,126 raste të reja në total në vitin 2023. Kjo rritje tregon një përshkallëzim të shpejtë të normës së incidencës së standardizuar sipas moshës së kancerit të gjirit dhe thekson nevojën urgjente për masa të përmirësuara për zbulimin e kancerit.

Si konkluzion, të gjithë referuesit dhe diskutantët theksuan se nevojitet një vëmendje e veçantë nga sistemi ynë shëndetësor për rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturale për një diagnozë sa më të shpejtë dhe të saktë të kancerit të gjirit, si dhe për një trajtim bashkëkohor të tij. Implementimi i diagnozës gjenetike të nënlojve të kancereve të gjirit paraqitet si një nevojë e domosdoshme për një mjekim sa më të saktë. Po kështu, rritja e kapaciteteve kimioterapeutike nëpërmjet rritjes së konsiderueshme të numrit të poltronave në repartin ditor të kimioterapisë, si dhe disponueshmëria e plotë e arsenalit bashkëkohor të medikamenteve të reja, është një domosdoshmëri tjetër e kohës. Kjo kërkon gjithashtu edhe rritjen e numrit të personelit të mesëm dhe të lartë në këtë sektor të rëndësishëm.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)



---

## **Akademia e të Rinjve bashkorganizatore e Simpoziumit shkencor “Gjuha dhe identiteti kombëtar”, ku prezantohet ARSH si pjesë e turit në institucionet e arsimit të lartë në vend**

Më 12-13 nëntor 2024, Akademia e të Rinjve së bashku me Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" organizuan simpoziumin shkencor me temë "Gjuha dhe identiteti kombëtar". Në këtë simpozium u prezantuan qëllimet, parimet dhe aktivitetet e Akademisë së të Rinjve nga kryetarja, znj. Belfjore Qose, si pjesë e turit në universitete, me qëllim rrjetëzimin dhe gjithëpërfshirjen e studiuesve të rinj. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe anëtari i ARSH-së, dr. Resul Telhaj, me kumtesën *“Arritje të gjuhësisë shqiptare: kontributi i departamentit të gjuhësisë në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”*, hartuar së bashku me dr. Lura Turhani (Koburja).

Simpoziumi u organizua në vazhden e veprimtarive në kuadër të "Vitet të gjuhës shqipe", miratuar nga MAS-i, ku u paraqitën kumtime që shpalosin arritjet, perspektivat dhe sfidat në kërkimet gjuhësore, identitetin tonë kombëtar nën presionin e globalizmit dhe letërsinë si konservuese dhe nxitëse e ndjenjave kombëtare. Në simpozium morën pjesë figura të shquara të gjuhësisë, të historisë dhe të letërsisë nga disa institucione, si: Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, etj.

---

## Akademik Ilirjan Malollari dhe akademik Kosta Barjaba, në Forumin Botëror të Shkencës në Budapest



Në datat 20-23 nëntor, në Budapest zhvilloi punimet Forumi Botëror i Shkencës. Në këtë forum, morën pjesë edhe anëtarët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Ilirjan Malollari dhe akad. Kosta Barjaba.



Forumi Botëror i Shkencës është një veprimtari e përbashkët e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), Këshillit Ndërkombëtar të Shkencës (ISC), Shoqatës Amerikane për Avancimin e Shkencës (AAAS), Partneritetit Akademik Internacional (IAP), Akademisë Botërore të Shkencave (TWAS), Bordit Këshillimor të Akademive Europiane të Shkencave (EASAC), Akademisë Globale të Rinjve (GYA) dhe Akademisë së Shkencave të Hungarisë (MTA). Kjo e fundit është mikpritëse e Forumit Botëror të Shkencës 2024.



Tema e Forumit ishte "Ballafaqimi i shkencës dhe politikave në kohën e transformimeve globale".

Forumi Botëror i Shkencës 2024 paraqiti sfidat kryesore teorike, praktike dhe institucionale në ballafaqimin mes shkencës, politikave dhe shoqërisë. Çështjet kryesore që u trajtuan në Forum ishin: rritja e besimit të shkencës; vlerësimi i rreziqeve në politikëbërje; koordinimi dhe bashkëpunimi në shkencë; mbështetja e përshpejtimin të Agjendës 2030.

Akad. Barjaba dhe akad. Malollari morën pjesë dhe kontribuan në disa sesione tematike të forumit, si:

- Ndërtimi i besimit në shkencë: Roli i shkencës së hapur dhe edukimit shkencor;
- Kapërcimi i hendekut: Besimi, politikat e mbështetura në të dhëna dhe vendimmarrja;
- Adresimi i ndryshimeve të ndryshimeve klimatike në shëndet: Pasiguritë dhe rreziqet;
- Workshop i nivelit të lartë mbi Zonën Europiane të Kërkimit;
- Liria shkencore, përgjegjësia dhe mbrojtja e shkencëtarëve;
- Fokusi në shkencën e hapur;
- Tryeza e rrumbullakët ministrore mbi forcimin e besimit në shkencë: Promovimi i lidhjes efektive shkencë-politikë-shoqëri dhe vlerave në shkencë;
- Tryeza e rrumbullakët ministrore mbi politikat shkencore, rreziqet dhe avantazhet;

---

-Tryeza e rrumbullakët ministrore mbi lirinë dhe sigurinë e shkencëtarëve;

- Vlerësi i rreziqeve në politikat shkencore;

-Matja e qëndrueshmërisë së zhvillimit: Duke shkuar përtej PBB-së, etj.

Gjatë qëndrimit në Budapest, akad. Barjaba dhe akad. Malollari zhvilluan takime me përfaqësues të akademive të shkencave pjesëmarrëse në forum.

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**



## Konferenca shkencore “Attraversamenti mediterranei”

Përfundoi konferenca shkencore “Attraversamenti mediterranei” e organizuar në universitetin “L’Orientale” të Napolit (Unior) nga katedra e gjuhës shqipe në bashkëpunim me katedra të tjera të gjuhëve të arealit mesdhetar-ballkanik. Në datë 29 tetor 2024, në sallën e konferencave të "Palazzo du Mesnil", filloi punimet konferenca shkencore “Attraversamenti mediterranei” ("Kryqëzime mesdhetare").

Krahas Universitetit "L'Orientale" dhe ASHSH, si organizatorë e bashkëpjesëmarrës ishin: Universiteti i Los Angelos-it, Universiteti “Capodistria” i Athinës, Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Monastirit, Tunizi.

- Akademia e Shkencave, e cila ka firmosur një marrëveshje dypalëshe me "Unior", ka mbështetur veprimtarinë e katedrës së shqipes, e cila drejtohet nga prof. dr. Blerina Suta, anëtare e komisionit të përhershëm të letërsisë pranë ASHSH.

- Për shqipen dhe trashëgiminë shqiptare referuan prof. dr. Blerina Suta (përgjegjëse e katedrës historike të shqipes në "Unior"); si dhe Andreas Dushi (BK) e Avdullah Rexhepi (UP)



Në sesionin e dytë të ditë së parë me temë “Ballkani dhe Lindja” ("I Balcani e l’Ovest") të drejtuar nga prof. dr. Blerina Suta, përgjegjëse e katedrës së shqipes pranë “Unior” dhe anëtare e komisionit të përhershëm të letërsisë pranë ASHSH, kumtuan: Abdulla Rexhepi (Universiteti i Prishtinës) me kumtesën “The poetic journey from East to West: the ideal Mediterranean in the poetics of Naim Frashëri”, si dhe Andreas Dushi (Biblioteka Kombëtare,

Tiranë): "Transition of the first novel in the Albanian Language: the case of "Marcia ose kshtenimi nfilles tvet".

Ndërsa në seksionin "Përshkime bashkëkohore" ("Attraversamenti contemporanei"), kumtoi Blerina Suta me: "Attraversamenti Mediterranei nella poetica filmica di Roland Sejko".



Në kumtesën "Marcia ose kshtenimi nfilles tvet" / "Kalimi mesdhetar i romanit të parë në gjuhën shqipe: rasti i 'Marcia, ose kshtenimi n'filles t'vet'" u theksua se në gjuhën shqipe zhanri i romanit është shumë i vonë, përkatësisht në fundin e shekullit XIX. Dom Ndoc Nikaj, një prift i ri, i cili në kujtimet e veta thotë se me këtë punë u mor kur akoma ishte diakon, i ofron lexuesit shqiptar një prozë të gjatë të titulluar "Marcia, ose kshtenimi n'filles t'vet" për të cilën vite më vonë, gazetatat thonë se u pëlqye dhe u lexua shumë. Jo vetëm në atë kohë, por deri me mbarimin e LIIB, ishte e zakonshme që shkrimtarët shqiptarë të merrnin vepra nga autorë të huaj, t'i përshtasin në shqip dhe t'ua ofronin lexuesve si vepra origjinale. Nikaj, ndonëse origjinaliteti krijues i tij vërehet gjatë leximit, tregohet i vërtetë dhe nuk e merr mbi vete autorësinë e plotë të tekstit, duke përdorur në frontespis një term të panjohur më parë, qiti (nxorri) në gjuhë shqiptare, por nuk e thotë se ku ishte origjina e tekstit. Gjatë punës sonë, e

---

identifikuam këtë tekst burimor. Fjala është për romanin “Marzia la Vestale, Raconto Storico dei Primi Tempi del Cristianesimo” të avv. E. Mastrachi-t. U trajtua po ashtu qasja që pjesët autoriale të Nikajt kanë me tekstin integral burimor dhe te natyra dhe mënyra se si ai e ndërton raportin mes tyre, për të zbërthyer kështu deri në çfarë niveli arrijnë krijimi, rikrijimi, përkthimi dhe ritregimi në këtë roman.

Shih më gjerësisht në linkun

<https://www.unior.it/.../sguardi-riflessi-lalba>

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

## U zhvillua workshop-i “Bujqësia e zgjuar në Shqipëri, arritje dhe sfida për të ardhmen”



Më 20 nëntor 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua workshop-i “Bujqësia e zgjuar/ Smart Agriculture në Shqipëri; arritjet dhe sfidat për të ardhmen” në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar.

Kjo veprimtari u përgatit dhe u zhvillua nën kujdesin e një komiteti nderi të kryesuar nga akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe me organizimin e një komiteti shkencor të drejtuar nga akad. asoc. dr. Fatbardh Sallaku.

Workshop-i u çel nga prof. dr. Vjollca Ibro, anëtare e Komisionit të biologjisë bujqësisë dhe veterinarisë. Ajo vuri në dukje se bujqësia si një shkencë jetësore e lidhur me ushqimin e popullsisë është njëherësh një multishkencë, e cila zhvillohet dhe modernizohet krahas shkencave të natyrës si biologjia, kimia e fizika, si dhe shkencave teknike. Qëllimi i këtij workshop-i për bujqësinë e zgjuar është njohja dhe demonstrimi i teknologjive dhe zgjidhjeve digjitale, që po transformojnë sektorin bujqësor.

Më pas prof.dr. Ibro ia dha fjalën akad. Vasil S. Toles, zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në emër të Kryesisë së kësaj akademie, akad. Tole përshëndeti organizatorët e forumit e në mënyrë të veçantë akad. Fatbardh Sallakun dhe prof. dr. Vjollca Ibron, si dhe



bashkëpunëtorët e tjerë, të cilët bashkuan studiuesit dhe specialistët më në zë të tokës dhe të teknologjisë bujqësore e bizneseve private që veprojnë në fushën e IT, e cila po gjen aplikim çdo ditë e më shumë në Shqipëri.

Akad. Tole theksoi se Akademia e Shkencave e mbështet këtë takim, sepse ndjekja e përvojave europiane mbetet një faktor thelbësor për të tejkaluar sfidat dhe për të përfituar nga potenciali i plotë i sektorit, duke përdorur elementet e “bujqësisë së zgjuar”.

Partneriteti i ngushtë i ASHSH-së, i Komisionit të përhershëm të bujqësisë pranë saj me UBT-në, do të mundësojë këshillime të vazhdueshme të ekspertëve në implementimin e praktikave më të mira të bujqësisë së zgjuar, si dhe do të orientojë të rinjtë drejt studimeve në fusha të tilla prioritare si bujqësia, inxhinieria e pyjeve, etj.

Znj. Anila Denaj, Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në fjalën e saj përshëndetëse i njohu të pranishmit me realizimet, buxhetin dhe projektet e BB dhe FAO, lidhur me dixhitalizimin dhe Smart Agriculture, që janë duke u implementuar. Ajo shprehu mbështetjen e vazhdueshme të qeverisë shqiptare dhe donatorëve, si FAO dhe Banka Botërore, me të cilët tashmë ka nisur puna për digjitalizimin e sektorit bujqësor, ndër të cilat edhe projektet DART, KRAD, etj.



Znj. Demaj vuri në dukje se tashmë portali i fermerit ofron informacione mbi tregjet dhe çmimet për mbi 40 produkte, duke rritur qasjen e fermerëve tanë në tregje të reja, ndërkohë që po punohet për modernizimin e sektorit drejt vizionit Bujqësia2030 dhe SHQIPËRIA2030 në

BE.

Më tej, zonja Demaj theksoi rëndësinë që ka hapja e dyerve të Akademisë për çështje që kanë të bëjnë me kërkimin dhe inovacionin në bujqësi dhe sugjeroi që gjetjet e këtij workshop-i të bëhen të njohura për të gjithë aktorët.



Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, z. Agim Rrapaj shprehu mirënjohjen për ftesën për bashkëpunim me ASHSH-në. Ai e vuri theksin në nevojën për mbështetje të prodhuesve, që aplikojnë forma të ndryshme të Smart Agriculture, duke përmirësuar operacionet. KASH përfshin në vetvete 25 shoqata kombëtare dhe 12 këshilla rajonale të agrobiznesit që operojnë në sektorët e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit dhe akuakulturës, agrobiznesit, agropërpunimit, bimëve mjekësore e aromatike dhe bletarisë, agroturizmit, agropylltarisë dhe mjedisit në zonat rurale, tregjeve agrolegtorale, financës dhe mikrofinancës.

Akad. asoc. dr. Fatbardh Sallaku, rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës falënderoi drejtuesit e MBZHR për bashkëpunimin dhe mbështetjen ndaj Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Kryesinë e ASHSH-së për hapjen e dyerve të këtij institucioni që është simbol i shkencës shqiptare ndaj veprimtarive të përbashkëta shkencore, të lidhura ngushtë me çështje të rëndësishme të bujqësisë e agrobiznesit, duke vënë në dispozicion një staf të shquar akademik.

Ai foli më tej për rëndësinë e projektit për ndërkombëtarëzimin e arsimit të lartë dhe konkretisht mbështetjen nga qeveria në projektin e bashkëpunimit me Universitetin BOKU të Vjenës.

Në këtë veprimtari referuan 15 pjesëmarrës nga universitetet, MBZHR, Instituti i Meteorologjisë, ekspertë të projekteve të BB dhe FAO dhe projekteve COST dhe Horizon, të lidhur me dixhitalizimin dhe shtrirjen e Smart Agriculture në Shqipëri. Gjithashtu, u sollën disa përvoja konkrete të aplikimit të Smart Agriculture në rajone të ndryshme të vendit dhe në Kosovë, sidomos, ato të lidhura me ujtitjen e zgjuar, plehërimin e zgjuar dhe përdorimin e

---

informacionit të sensorëve në marrjen e vendimeve për ujitje, plehërim, trajtim me PMB apo për përshtatjen e kohës së vjeljes së frutave, etj.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

# **Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH**



## Zhvillohet mbledhja e radhës e komisionit të mjekësisë me temën “Sëmundjet autoimune, epidemiologjia dhe roli i tyre në sëmundshmërinë e përgjithshme”

Më 11 nëntor 2024 në Akademinë e Shkencave në bashkëpunim me Seksionin e Shkencave Natyrore dhe Teknike u zhvillua mbledhja e radhës së komisionit të mjekësisë me temën “Sëmundjet autoimune, epidemiologjia dhe roli i tyre në sëmundshmërinë e përgjithshme”.

Mbledhja u hap nga kryetari i komisionit akad. Genc Sulçebe, i cili pasi u uroi mirëseardhjen të pranishmëve, tha se paraqitja e temave të tilla dhe pasqyrimi i tyre në media shërben dhe si një kampanë sensibilizimi për njohjen e këtyre problematikave nga i gjithë sistemi shëndetësor.



"Qendra e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës pranë Akademisë së Shkencave nëpërmjet projekteve të saj është e impenjuar aktualisht dhe në studimin e sëmundjeve autoimune duke u fokusuar në hulumtimin e ndikimit gjenetik dhe mjedisor në shfaqjen e tyre. Në këtë studim një fokus i veçantë i dedikohet diagnozës së saktë të këtyre sëmundjeve me anë të ekzaminimeve të reja imunologjike që po aplikohen për herë të parë në vendin tonë dhe që po ndihmojnë pacientët në nevojë për këto ekzaminime."-tha akad. Sulçebe.

Më pas fjala ju dha prof. asoc. Arbi Pecanit, i cili bëri një paraqitje gjithëpërfshirëse, duke krijuar një tablo të plotë të sëmundjeve autoimune, si dhe krahasimin me vendet e tjera të rajonit.

ai tha se sëmundjet autoimune shfaqen kur sistemi imunitar sulmon gabimisht qelizat,

indet apo vetë organet e shëndetshme të trupit të tij, duke i konsideruar ato si "të huaja". Normalisht, sistemi imunitar mbron trupin nga infeksionet dhe patogjenët si bakteret dhe viruset, por në rastin e sëmundjeve autoimune, ky proces nuk zhvillohet tamam ndaj dhe shkakton dëme në indet dhe organet e trupit. Shkaqet e sëmundjeve autoimune përfshijnë një kombinim të faktorëve gjenetikë, faktorë të jashtëm mjedisorë dhe faktorëve të brendshëm shpesh hormonalë. Janë mbi 100 sëmundje autoimmune të indentifikuara deri më sot ku 30% e popullatës botërore vuan nga të paktën një sëmundje autoimmune.



Të gjithë pacientët që kanë të paktën një sëmundje autoimmune kanë 25% mundësi që të zhvillojnë edhe një sëmundje tjetër autoimmune gjatë gjithë jetës së tyre. Sëmundjet autoimune hasen më shumë në vendet e industrializuara sesa në ato vende që janë akoma në zhvillim. Ato prekin më shumë femrat (70%), ndërsa meshkujt (30%). Prevalenca e sëmundjeve autoimune është një shqetësim në rritje në mbarë botën, dhe këto sëmundje kanë një ndikim të konsiderueshëm në shëndetin publik. Kjo rritje e dukshme mund të lidhet me faktorë të ndryshëm, përfshirë faktorët e mjedisit, ndryshimet në dietën ushqimore, ndryshimet hormonale. Një nga faktorët më të rëndësishëm që po ndihmon në rritjen e prevalencës është përmirësimi i diagnozës dhe mundësitë e avancuara për të zbuluar sëmundjet autoimune. Për

---

më tepër, me rritjen e jetëgjatësisë mund të shihen gjithashtu më shumë raste të sëmundjeve autoimune. Prevalenca mund të ndryshojë sipas rajonit dhe llojit të sëmundjes autoimune.

Sëmundjet autoimune kanë një ndikim të ndjeshëm në shëndetin publik dhe në ekonominë e një vendi. Ato rrisin kostot e kujdesit shëndetësor dhe përballen me sfida të mëdha për sistemet mjekësore, duke përfshirë rritjen e shpenzimeve për trajtim, asistencë sociale dhe kërkime. Po ashtu, ato çojnë në humbje të produktivitetit dhe mund të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të një vendi. Për të menaxhuar këtë ndikim, është e rëndësishme të zhvillohen strategji për diagnostikimin e hershëm, menaxhimin efikas të sëmundjeve autoimune dhe përmirësimin e trajtimeve dhe mbështetjes për pacientët.

Më pas, prof. Xheladin Dracini, theksoi se pandemitë kanë lënë gjurmë në imunitetin e popullatës, duke ndikuar dhe në shfaqjen e sëmundjeve autoimune.

Prof. Alban Ylli u shpreh se Instituti i Shëndetit Publik, merret edhe me studime dhe problematika që kanë lidhje me sëmundjet më të rralla që prekin popullatën. Për këto sëmundje duhet të kemi një njohje më të mirë, më shumë informacione si dhe politika të qarta. Si sisteme informacioni ka rëndësi të sigurohen të dhëna të besueshme nga sistemi shëndetësor si dhe qendrat kërkimore.

Prof. Albana Fico vuri në dukje se për sëmundjet autoimune kemi një sistem të copëzuar dhe për Shqipërinë këto të dhëna janë shumë të pakta. Një rifreskim i hartës së sëmundshmërisë do ishte një gjë me shumë vlerë. Kjo do të japë një ndihmesë të rëndësishme në diagnostikimin dhe trajtimin e tyre.

Si konkluzion, trajtimi i temave të tilla madhore është me vlerë dhe këtu del në pah puna dhe kontributi i Akademisë së Shkencave nëpërmjet Qendrës së Bioteknologjisë dhe Gjenetikës në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë, QSUNT, si dhe Institutin e Shëndetit Publik.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

# Vlerësime



---

## Akademik Anastas Angjeli vlerësohet me çmimin e karrierës në Panairin e 27-të librit



Sot më 16 nëntor 2024 akad. Anastas Angjeli u vlerësua me çmimin e veçantë të karrierës në panairin e 27- të librit.

Ky çmim iu akordua nga Shoqata e Botuesve Shqiptarë me motivacionin “për kontributin e gjatë në studimet e jetës ekonomike dhe politike të Shqipërisë. Çmimi i referohet specifikisht librit më të fundit të autorit "Institucionet e Bretton Woods dhe Shqipëria". Më herët në një mjedis studiuesish të fushës, përfaqësues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Kosovës, politikës dhe studentësh, libri pati një sërë vlerësimesh e rencensash.

Libri “Institucionet e Bretton Woods dhe Shqipëria”, është një vepër që ofron një analizë të thellë mbi ndikimin dhe rolin e institucioneve financiare ndërkombëtare në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Ky libër, është një pasqyrë e detajuar mbi marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe institucioneve të Bretton Woods, si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, duke eksploruar sfidat dhe mundësitë që këto institucione i kanë ofruar vendit në procesin e tij të integritimit në ekonominë globale.

---

Akad. Anastas Angjeli përmes këtij libri shqyrton politika, reforma dhe ndikimet e ndryshme që këto institucione kanë pasur në zhvillimin e Shqipërisë pas rënies së regjimit komunist.



Analizat e thella dhe shembujt konkretë janë një burim i vlefshëm për studentët, akademikët dhe profesionistët që interesohen për ekonominë shqiptare dhe proceset e zhvillimit global. Me njohuritë e tij të thella në fushën e ekonomisë dhe politikës., akad. Agjeli ofron një perspektivë të re mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe sfidat që Shqipëria ka përballuar.

Akad. Vasil Tole, zëvendeskryetar i AShSh përmes kumtesës së tij theksoi se ky botim është vlerë e shtuar e mendimit më të mirë ekonomik në Shqipëri.

Gjithashtu për librin kumtuan edhe akad. Adrian Civici dhe Përparim Kabo. Akad. Civici tha se ky libër ofron një kolanë historike të ngjarjeve, shkaqeve dhe teorive ekonomike, të cilat i paraprinë krijimit të institucioneve të Bretton Woods. Këto institucione u ndërtuan mbi 3 parime bazë dhe me qëllimi ruajtjen dhe stabilitetin ekonomik e financiar. Krijimi i tyre, u bazua në krijimin dhe fuqizimin e institucioneve demokratike, garantimin e stabilitetit ekonomik e financiar dhe mundësisë së lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve, kapitaleve e ideve dhe së treti, garantimi i mbështetjes me kapitale të mjaftueshme financiare për të siguruar rimëkëmbjen nga krizat dhe zhvillimin ekonomik afatgjë.

---

## Akad. Nazim Gruda zgjidhet si shkencëtar i shquar nga Akademia e Shkencave e Kinës



Akad. Nazim Gruda, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, është zgjedhur për herë të dytë si shkencëtar i shquar nga Akademia e Shkencave e Kinës.

Ai është një nga specialistët dhe shkencëtarët më të shquar në fushën e hortikulturës në Shqipëri dhe në Europë. Aktualisht është zëvendës-president i Unionit të Akademive Europiane për Shkencat e Aplikuara të Bujqësisë, Ushqimit dhe Natyrës (UEAA), zv. Kryetar i Seksionit të Perimeve, Bimëve Rrënjore e Zhardhokore dhe Kryetar i Grupit të Punës për Evropën Juglindore të Shoqatës Ndërkombëtare të Shkencave të Hortikulturës.

Akad. Gruda është autor i mbi 350 punimeve shkencore, prej të cilave mbi 150 në Scopus dhe renditet si kërkues me punime me një indeks citimi shumë të lartë.

Edhe në vlerësimin e kryer nga ekspertët e Universitetit të Stanfordit në SHBA, vitet e fundit ai renditet në 2 % të shkencëtarëve më me ndikim në "World's Top 2 per cent Scientists".

Në Kinë ai kooperon me shumë shkencëtarë, po ky fellowship i jep mundësinë të vijojë studimet dhe bashkëpunimin me shkencëtarët e Akademisë së Shkencave në Nanjing.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)



## Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi vlerësohet me çmimin “Sami Frashëri” për veprën monografike historike "Wilhelm zu Wied dhe Shqipëria"

Bashkia e Belshit kurorëzoi dje më 31 tetor 2024 konkursin e shpallur për vepra në fushat e publicistikës, letërsisë dhe albanologjisë, që mban emrin e rilindësit tonë të shquar Sami Frashëri.



Punonjësi i Institutit të Historisë prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi e mori këtë çmim për fushën e albanologjisë me veprën monografike historiografike "Wilhelm zu Wied dhe Shqipëria (mars - shtator 1914).





---

Çmimi “Sami Frashëri” iu dha prof. asoc. dr. Marenglen Kasmit me këtë motivacionin:

“I pajisur me dije të konsoliduara historike, me material burimor arkivor të dorës së parë, me informacionet shumë të pasura nga shtypi i kohës, autori Marenglen Kasmi sjell për herë të parë një monografi për Princ Vidin. Në mënyrë shumë objektive ai arrin të paraqesë një segment kohor shumë të ndërlikuar nga historia e Shqipërisë. Aty dalin qartë përpjekjet e mundimshme për konsolidimin e pavarësisë së brishtë, duke përballuar synimet aneksuese të fqinjëve. Përshkruhen me detaje tërësisht të reja përpjekjet shtetformuese dhe arritjet e pajtimit social. Aty del në dritë njëkohësisht orientimi i arsyeshëm ndërkombëtar i klasës progresive shqiptare, e cila synoi shkëputjen nga Lindja dhe inkuadrimin në Perëndim.

Fituesit e dy çmimeve të tjera janë:

Bujar Hudhri, botues për të përjavshme "ex Libris";

Ben Blushi, shkrimtar, për romanin "Komploti".

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

Shih dhe:

<https://www.gazetatema.net/.../prof-asoc-dr-marenglen...>

<https://shqiptarja.com/.../mbahet-edicioni-i-pare-i...>

---

**Promovime**

## U prezantua botimi “Sfidat e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri e rajon”, botim i përbashkët i ASHSH dhe ASHAK



Sot më 15 nëntor 2024, në kuadër të panairit të 27-të të librit, që po mbahet këto ditë në Pallatin e Kongreseve, u prezantua libri “Sfidat e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri e rajon”, botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.


Prezantimi u bë në kujdesin e akademikëve Justina Shiroka-Pula, akad. Isa Mustafa, akad. Anastas Angjeli e akad. Adrian Civici, njëherësh dhe organizatorë të konferencës.

U theksuan drejtimit kryesore të bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-Kosovë e në rajon, që janë sjellë në këtë botim përmes 70 punimeve të akademikëve, profesorëve, kërkuesve shkencorë më në zë në të dy vendet.

Libri “Sfidat dhe perspektivat e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon” është botuar në Prishtinë dhe përmban aktet e konferencës me të njëjtin titull, organizuar më 6-7 tetor 2023 nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (ASHAK) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), me pjesëmarrjen e studiuesve shqiptarë e të huaj nga fushat e ekonomisë, financës, bankingut, tregtisë, mirëqeverisjes, politikave të zhvillimit, çështjeve gjeorajonale dhe të marrëdhënieve ndërshtetërore.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

## U përurua libri "Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike", vëllimi III



Sot më 23 nëntor 2024 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua përurimi i librit "Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike", vëllimi III.

Veprimtaria u organizua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në kuadër të panairit të 27-të librit që po mbahet këto ditë në Tiranë.

Botimi është përgatitur nga akad. Shaban Sinani dhe akad. Pëllumb Xhufi.

Akad. asoc. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore Albanologjike, prezantoi bërthamën e 20 kontributeve shkencore të përfshira në vëllimin e tretë, të cilat u referuan gjatë ditëve të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike të organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, mbajtur në Tiranë në datat 25-27 nëntor 2021.

Ky kuvend mbledhi në Tiranë 182 studiues shqiptarë dhe të huaj, mes të cilëve albanologë të njohur, nga universitete dhe qendra kërkimore të huaja që kryejnë studime për botën shqiptare.

Akad. asoc. Hoxha vuri në dukje se kuvendi solli në Tiranë albanologët më të njohur nga vende të ndryshme të Botës si Pierre Cabanes, Francë; Lucia Nadin, Itali; Jose Manuel



Floristan, Spanjë; Peter Schreiner, Gjermani; Maria Tereza Morelli, Itali; Irene Sawicka, Poloni; Leonardo Maria Savoia, Itali etj.



Punimet shkencore të paraqitura në vëllimin e tretë të veprës “Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike” kanë thelluar kërkimet për çështje të tilla si vijimësia iliro-shqiptare, shqipja si gjuhë indoeuropiane dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët motra të kësaj familjeje, trashëgimia e shqiptarëve në trojet etnike, të cilat në këtë kuvend u pasuruan me vështrime nga disiplina të tjera dhe përmes analizave mbështetën teoritë moderne që hedhin një dritë të re për origjinën, gjuhën, kulturën dhe qytetërimin shqiptar në trojet e veta.



Kuvendi Ndërkombëtar i Studimeve Albanologjike, aktet e të cilit tashmë përfshihen në tri vëllime, ishte një veprimtari e përmasave nga më të mëdhatë në fushën e albanologjisë, që prej vitit 1972, kohë kur u mbajt në Tiranë Kuvendi Ndërkombëtar i Studimeve Ilire, që bëri një bilanc të plotë të të gjitha arritjeve të shënuara deri në atë kohë për historisë e shqiptarëve,

---

prejardhjen e tyre, gjuhën shqipe, duke treguar vijimësinë iliro-shqiptare përmes argumenteve historikë, arkeologjikë dhe gjuhësorë.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

## U përurua libri "The earthquake of 26 november 2019 and what can we learn" me autorë akad. asoc. Rrapo Ormënin dhe Serkan Öztürk



Sot më 23 nëntor 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua përurimi i librit: "The earthquake of 26 november 2019 and what can we learn" ("Tërmeti i 26 nëntorit dhe refleksionet e nxjerra prej tij") me autorë akad. asoc. Rrapo Ormënin dhe Serkan Öztürk.

Veprimtaria u drejtua nga akad. Ilirjan Malollari. Ai e vlerësoi librin për analizën e thelluar dhe gjithëpërfshirëse të një ngjarjeje tërmetore, ku trajtohen në mënyrë shkencore aspekte të rëndësishme, si përhapja e valëve sizmike, ndërgjegjësimi për rreziqet, për procedurat e evakuimit, si dhe për masat që duhet të marrë qeveria për dëmet, për evakuimin dhe ndërtimet pa kriter.

Akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave, mbajti një fjalë përshëndetëse, ku vlerësoi punën e autorëve Rrapo Ormëni dhe Serkan Öztürk për produktin shkencor dhe mesazhet që ka libri për të gjitha kategoritë e komunitetit, veçanërisht për vendimmarrësit kryesorë të ekzekutivit dhe këshilltarët e tyre, për të përgatitur strategji më të mira për të ardhmen.

Veprimtarinë e përshëndeti edhe z. Metin Bulut këshilltar i arsimit në Ambasadën e Republikës së Turqisë në Shqipëri, i cili vlerësoi bashkëpunimin mes dy vendeve në fushën e shkencës dhe arsimit.



Për veprën folën ekspertë të njohur të sizmikës prof. dr. Vilson Silo, prof. dr. Ismail Hoxha, prof. dr. Naser Peçi (Kosovë), të cilët e vlerësuan librin si një burim me vlera për studimet sizmike dhe për menaxhimin e fatkeqësive natyrore në vendin tonë.

Akad. asoc. Rrapo Ormeni bëri një prezantim të shkurtër të librit dhe foli për bashkëpunimin e ngushtë me sizmologun nga Turqia, prof. Serkan Ozturk bashkautor i librit.

Mes të tjerave ai falënderoi akad. Skënder Gjinushin dhe Kryesinë e ASHSH, që e mbështeti për idenë e organizimit më 26 nëntor 2020 të konferencës së madhe ndërkombëtare mjaft të suksesshme "Gjeoshkencat dhe inxhinieria e tërmeteve, sfidat në rajonin e Ballkanit".

Në fund të fjalës së tij, akad. asoc. Rrapo Ormeni tha se refleksionet e nxjerra nga tërmeti i 26 nëntorit për përgatitjen dhe mbrojtjen nga tërmetet mund të shërbejnë si udhëzues i vlefshëm për individët dhe komunitetet që dëshirojnë të vetëmbrohen dhe të minimizojnë dëmet nga tërmetet e ardhshme.

Lajmi në TV Top Channel

<https://www.youtube.com/watch?v=Nbia6iHDSXs>

Lajmi në TV Ora News:

<https://www.youtube.com/watch?v=letuErjn9ZE>

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)



---

**U përurua vepra "Historiografia e artit të tingullit në botën shqiptare (nga prehistoria në antikitet)", me autor prof. dr. Edmond Buharaja, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.**

Sot më 14 nëntor 2024, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Studimit të Arteve dhe Fakulteti i Muzikës - UART zhvilluan përurimin e librit "Historiografia e artit të tingullit në botën shqiptare (nga prehistoria në antikitet)" e autorit prof. dr. Edmond Buharaja.



Libri u prezantua nga akad. Vasil S. Tole, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Pasi përshëndeti pjesëmarrësit, ai tha se nuk do të dëshironim që ky promovim i librit të Edit të bëhej pa të, pa prezencën e tij sot. Por ja, kështu ndodhi, që Edmond Buharaja (1964-2024), miku, shoku, kolegu, kompozitori, muzikologu, pedagogu, intelektual i artit u nda nga ne dhe familja në mënyrë të beftë, duke lënë pas emrin e tij të nderuar dhe trashëgiminë e tij muzikore, një pjesë të së cilës, ndoshta më të rëndësishmen e promovojmë sot.

Në emër të kryesisë së Akademisë së Shkencave, akad. Tole i ftoi të pranishmit që të mbanin një minutë heshtje në shenjë nderimi për prof. dr. Buharanë.

Akad. Tole foli për figurën e prof. dr. Edmond Buharasë si pedagog në Universitetin e Arteve, si themelues programesh mësimore e drejtues departamentesh të muzikës, si teoricien i muzikës, si kompozitor, etj.

Më tej, akad. Vasil Tole foli për veprën e prof. dr. Buharasë "Historiografia e artit të tingullit në botën shqiptare". Ai tha se kjo vepër synon ta shtjellojë objektin e vet përmes

shfrytëzimit të instrumenteve dhe të të dhënave të nxjerra nga të gjitha disiplinat shkencore të përfshira, të cilat janë shumë, nga ato historike, gjuhësore e gjenetike, antropologjike, estetike, muzikologji e krahasuar, semantika e semiotika, historia e muzikës, etj.



Me termin “botë shqiptare”, Buharaja i referohet asaj, e cila përfshihet brenda kufijve të sotëm të republikave të Shqipërisë dhe Kosovës si dhe ato në Itali, Mali i Zi, Serbi, Maqedonia e Veriut, Bullgari dhe Greqi. Do të mendohen si pjesë e tij edhe të shpërngulurit për në Rumani, ish-Bashkimi Sovjetik, Turqi, Egjipt dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Libri i kushtohet gjyshit të tij, Vexhi Buharasë, i cili me jetën dhe veprën e tij ka qenë për Edin “horizont orientues për këtë historiografi”.-tha akad. Tole.

Ai foli për tre pjesët e librit të strukturuar në 6 kapituj gjithsej, secili prej kapitujve me shumë nënndarje, që ashtu si gurët e mozaikut krijojnë pamjen e së tërës lëndë.

“Si e tillë, historiografia e shprehjes muzikore shqiptare, paralelisht me simotrat e saj më të mëdha e më të hershme, kalon nga epoka mitologjike përmes asaj teologjike, për tek Pozitivizmi bashkëkohor. Këtu e shohim edhe kontributin e Buharasë, pasi sjell një abstragim dhe interpretim të tij mbi artin e tingullit tek ne, deri diku i patrajtuar në tërësi si i tillë.

I paharruar kujtimi dhe trashëgimia artistike e shkencore që Edi la pas!”, - tha akad. Tole.

Në fund të veprimtarisë u mbajt një koncert me vepra të kompozuar nga prof. dr. Eddmond Buharaja.

Veprimtaria u organizua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim me Qendrën e Studimit të Arteve pranë ASHSH-së dhe Fakultetin e muzikës - UART.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

Shih dhe:

<https://ata.gov.al/.../historiografia-e-artit-te.../>

<https://www.kultplus.com/.../historiografia-e-artit.../...>

---

**Përrurohen librat “Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore” dhe “Krijimtaria letrare e Ali Aliut”, botime të dy akademive të shkencave Shqipëri-Kosovë**

Sot më 15 nëntor 2024 në Pallatin e Kongreseve u përruruan dy libra të botuar nga Akademia e Shkencave e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë: “Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore” dhe “Krijimtaria letrare e Ali Aliut”.



Në këtë përrurim folën akad. Mehmet Kraja, Kryetar i ASHAK; akad. Vasil S. Tole, zëvendëskryetar i ASHSH; akad. Sabri Hamiti, akad. Rexhep Ismajli; si dhe studiuesit Nysret Krasniqi, e të tjerë.

Libri vëllimor me 518 faqe “Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore”, është i pesti me studime nga seria e konferencave të suksesshme ndërkombëtare për studimet albanistike jashtë hapësirës shqiptare.

Ky libër i përgatitur nga akad. Rexhep Ismajli sjell 40 referime, analiza, shqyrtime, diskutime për aspekte të ndryshme të interesimeve për botën shqiptare të autorëve britanikë dhe të Europës Veriore, akte të konferencës shkencore “Studimet për shqiptarët në Britaninë e



Madhe dhe në vendet e Europës Veriore”, që u mbajt në Prishtinë, më 16 tetor 2024.



Kjo gjerësi vështrimesh lidhur me botën shqiptare në opinionin shkencor e kulturor britanik ka qenë e ndërlidhur me shumë aspekte të zhvillimeve historike në Europën e atëhershme, sidomos me aspektet e interesimit të Europës Perëndimore - Francë, Britani, Itali në raport me Perandorinë Osmane. Bien në sy përqendrimet e shpeshta rreth veprave të autorëve si Lordi Byron, Stuart Mann, Edith Durham, Noel Malcolm, Christian Sandfeld, Holger Pedersen, Arthur Evans dhe John Ęilkes, por në përgjithësi horizonti vjen e zgjerohet më shumë sesa në konferencat e tjera, tani jo më vetëm në gjuhësi, po edhe në letërsi, në studimet etnologjike-etnografike, në arkeologji, e deri edhe në aspektet gjeopolitike e historiografike.

Autorët britanikë për gati tre shekuj, me gjithë largësinë gjeografike, kanë dhënë një ndihmesë me vlerë për njohjen e botës shqiptare. Interesimet për shqiptarët, për gjuhën, kulturën dhe historinë e tyre, nuk kanë munguar.



---

Përurimi i dy botimeve është organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës që kanë qenë dhe organizatore të konferencës shkencore me temën “Studimet për shqiptarët në Britani dhe në vendet e Europës Veriore” dhe të tryezës shkencore “Krijimtaria letrare e Ali Aliut” që u mbajt në kuadër të 90-vjetorit të lindjes së studiuesit të njohur.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

## **Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u bë sot promovimi i librit “Përrallëtarët e gjuhës shqipe” të autorit Ardian Vehbiu, botim i shtëpisë botuese “Naimi”**

Sot, më 6 nëntor 2024, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u bë promovimi i librit “Përrallëtarët e gjuhës shqipe” i autorit Ardian Vehbiu, anëtar i jashtëm i ASHSH

- Veprimtaria u zhvillua me pjesëmarrjen e studiuesve të gjuhësisë, letërsisë, antropologjisë kulturore dhe dijeve të tjera albanologjike -

- I pranishëm akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave, i cili përshëndeti autorin dhe botimin -

# **ARDIAN VEHBIU**

## **Përrallëtarët e gjuhës shqipe**



Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u bë sot promovimi i librit “Përrallëtarët e gjuhës shqipe” të autorit Ardian Vehbiu, botim i shtëpisë botuese “Naimi”.

Libri i sapobotuar kërkon të jetë një përgjigje e arsyetuar ndaj gjithë atyre që duan të rrëzojnë traditën albanologjike dhe rezultatet e studimeve serioze për gjuhën shqipe dhe

historinë e saj.



Pas hapjes së aktivitetit nga prof. dr. Mimoza Kore, iu dha fjala autorit, i cili falënderoi Akademinë e Shkencave për mbështetjen dhe botuesin për nxitjen që i dha për të botuar këtë vëllim. Ai theksoi se ka synuar të flasë me lexuesin e thjeshtë, i interesuar për çështje shumë të rëndësishme, si ajo e shumëdebatuara për lashtësinë e shqipes - midis të tjerash.

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi përshëndeti e uroi autorin për këtë botim të vlefshëm e kurajoz, duke nënvizuar edhe kritikën konstruktive që bëhet nga autori për rolin që duhet të luajë Akademia e Shkencave në mbrojtjen e tezave shkencore.





Më tej, prof. asoc. dr. Teuta Toska, gjatë fjalës së saj theksoi se leximi i librit të Ardian Vehbiut e pajis dashamirin e shqipes, studentin e gjuhësisë me një metodë sesi mund ta demontojë gabimin dhe të mbrojë mënyrën shkencore sesi e bën këtë demontim. E ndihmon të përdorë njohuritë bazike nga kurse edhe të gjuhësisë sinkronike, për më tepër të gjuhësisë diakronike, si mjet analize e kritike. Ky libër duhet të nxisë ata që merren me hartimin e kurrikulave universitare të kuptojnë nevojën e studentëve, studiuesve e intelektualëve të ardhshëm, për njohuri të shkencës së gjuhësisë shqiptare, veçanërisht të atyre që studiojnë shkencat humane (histori, arkeologji, sociologji, pedagogji, antropologji, etnologji, filozofi, gazetari). Por edhe ne që merremi me mësimdhënien universitare të gjuhësisë duhet ta pajisim studentin me dijen e domosdoshme për të qëndruar në karakterin shkencor të dijeve mbi gjuhën dhe për të dekonstruktuar informacionin alternativ nga folk-etimologët.



Sipas prof. T. Toska, ky libër i Ardian Vehbiut mbush një zbrazëti dhe iu jep përgjigje pyetjeve të studentëve e dashamirëve të shqipes që e dyshojnë vlerën e këtyre ideve, por nuk janë të pajisur me argumentin bindës.

Sipas autorit, libri “Përrallëtarët e gjuhës shqipe” vjen në rrjedhën e debatit për origjinën e gjuhës shqipe dhe është menduar si një përpjekje për të kundërshtuar, sistematikisht, denigrimin e albanologjisë nga alternativët, amatorët dhe demagogët; të cilët, falë edhe simpatisë së papërgjegjshme të masmediave dhe frymës konspirativiste që këto ushqejnë, tani gëzojnë një numër të habitshëm ndjekësish dhe përkrahësish anembanë botës shqiptare.

Gjatë promovimit, nga të pranishmit u theksua roli i medias në seleksionimin e lajmeve e diskutimeve për çështje shkencore të rëndësishme siç është ajo e lashtësisë dhe rrugëtimit të

---

gjuhës shqipe, ku fjalën duhet ta thonë specialistët e t'u jepet hapësirë tezave e argumenteve shkencore e jo deformimit e keqpërdorimit të tyre deri në mënyrë abuzive; se vetë institucionet shkencore e Akademia e Shkencave duhet të shprehin e mbrojnë më qartë qëndrimin e tyre e kontributin e gjuhëtarëve e akademikëve tanë në formulimin e argumentimin e lashtësisë e origjinës së gjuhës shqipe si një degë e hershme e gjuhëve indoeuropiane, në rolin që duhet të luajë edhe formimi i të rinjve në shkolla për të dalluar të vërtetat shkencore nga ato amatoreske që i shvleftësojnë ato.

Libri “Përrallëtarët e gjuhës shqipe” ka karakterin e një studimi monografik dhe është botuar nga "Naimi", shtëpi botuese dhe studio letrare. Autori i tij Ardian Vehbiu është diplomuar në Tiranë për gjuhë-letërsi shqipe në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës; pastaj ka studiuar për gjuhësi historike dhe teorike në Romë (Universiteti “La Sapienza”). A. Vehbiu ka punuar në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave, si dhe në Institutin Oriental të Napolit. Ai është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

Shih në linkun në vijim lajmin në media:

<https://ata.gov.al/.../perralletaret-e-gjuhes-shqipe.../>

<https://www.gazetatema.net/.../ardian-vehbiu-vjen-me...>

<https://almanart.al/.../promovim-libri-perralletaret-e.../>

<https://www.gazetatema.net/.../promovohet-ne-sallen-aleks...>

<https://www.oranews.tv/.../perralletaret-e-gjuhes-shqipe...>

<https://fax.al/.../promovohet-ne-sallen-aleks-buda-libri...>

---

**Në sallën "Akademikët" të ASHSH u promovua libri "Kompleksi ligatinor i Kune-Vainit (Lezhë, Shqipëri) - qasja ekologjike"**

Prezanton botimin: prof. dr. Aleko Miho

Në këtë botim jepen për herë të parë në Shqipëri gjetjet shkencore gjithëpërfshirëse gjatë punës në kuadër të programit kërkimor të përbashkët "Qasja ekologjike e kompleksit lagunor të Kune-Vainit, Lezhë", pjesë e projektit "Sigurimi i qëndrueshmërisë së sistemit lagunor të Kune-Vainit përmes përshtatjes së ekosistemit (EbA)".

Këto të dhëna nga secili grup janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur edhe në ngjarje shkencore, ose janë botuar në revista shkencore, brenda ose jashtë vendit. Por këtu ato vijnë më të plota dhe gjithëpërfshirëse, sidomos për përmbajtjen e të dhënave dhe diskutimin e tyre, paraqitjen tabelare, grafike ose ilustrimin e mirë me foto të llojeve, habitateve sidomos të llojeve mikroskopike.

Të grupuara në një vëllim të vetëm ato ndihmojnë më mirë në njohjen tërësore të këtij ekosistemi me rëndësi për Lezhën, vendin dhe gjithë rajonin.

Rezultatet dhe rekomandimet e këtij studimi së bashku ndihmojnë administratën e ZM, Lezhë, vendimmarrjen vendore dhe ekspertizën mjedisore vendase në njohjen më mirë të gjendjes, por jo vetëm, edhe në ruajtjen dhe ripërtëritjen ekologjike në të ardhmen, për një menaxhim më të mirë, në përmbushjen e standardeve të kërkuara në shkallë ndërkombëtare.

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**

